FLETORJA ZYRTARE E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Botim i Qendrës së Publikimeve Zyrtare

www.qpz.gov.al

Nr. 98 10 gusht 2012

P Ë R M B A J T J A

		Faqe
Udhëzim i MPPT dhe MB nr. 9, datë 3.7.2012	Mbi auditimin dhe inspektimin e sigurisë rrugore……	5303

UDHËZIM
Nr. 9, datë 3.7.2012

MBI AUDITIMIN DHE INSPEKTIMIN E SIGURISË RRUGORE

Në mbështetje të nenit 102 pika 4 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, nenit 35 pika 3 të ligjit nr. 8378, datë 22.7.1998 "Kodi Rrugor i Republikës së Shqipërisë", të ndryshuar, si dhe vendimit nr. 815, datë 23.11.2011 të Këshillit të Ministrave "Për një ndryshim në vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 153, datë 7.4.2000 "Për miratimin e rregullores së zbatimit të Kodit Rrugor të Republikës së Shqipërisë", të ndryshuar, Ministri i Punëve Publike dhe Transportit, si dhe Ministri i Brendshëm

UDHËZOJNË:

KAPITULLI I
DISPOZITA TË PËRGJITHSHME

Neni 1
Qëllimi

1. Ky udhëzim ka të bëjë me zbatimin e procedurave në lidhje me auditimin gjatë fazës së projektimit, ndërtimit, si dhe inspektimin gjatë funksionimit të rrjetit rrugor (autostradat, rrugët interurbane, urbane, lokale, përfshirë rrugët, të cilat janë pjesë e rrjetit kryesor të Europës), për menaxhimin sa më të mirë të sigurisë rrugore.

2. Qëllimi i këtij udhëzimi është:

- të përcaktojë procedurat e auditimit dhe inspektimit për aktivitetet e sigurisë në rrugë;
- të përcaktojë kushtet për të vepruar, si dhe për të kryer funksionet si një auditues/inspektor i pavarur;
- të përcaktojë tarifa për aktivitetet e auditimit dhe inspektimit, si dhe për kurset e trajnimit e të testimit;
- të përcaktojë detyrat dhe funksionet kryesore, mbi organet përgjegjëse të auditimit dhe inspektimit në fushën e sigurisë rrugore.

Neni 2
Përkufizime

Për qëllime të këtij udhëzimi, zbatohen përkufizimet e mëposhtme:

a) Auditim (Auditim i Sigurisë Rrugore – ASR)

Do të thotë një kontroll i pavarur, sistematik dhe me detaje, mbi çështje teknike të sigurisë rrugore në lidhje me një projekt të infrastrukturës rrugore që mbulon katër fazat e tij, referuar vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 815, datë 23.11.2011 "Për një ndryshim në vendimin e Këshillit të Ministrave, nr. 153, datë 7.4.2000 "Për miratimin e rregullores së zbatimit të Kodit Rrugor të Republikës së Shqipërisë", të ndryshuar.

b) Auditues (Auditues i Sigurisë Rrugore)

Është një person juridik ose fizik, i cili është i certifikuar dhe kryen funksionet në mënyrë të pavarur dhe në përputhje me këtë udhëzim;

c) Raporti i auditimit

Është një raport me shkrim, i cili përmban rezultatet e kontrollit me të metat në aspekte të sigurisë rrugore të identifikuara, si dhe rekomandimet;

d) Klienti

Është enti pronar i rrugëve (zakonisht Autoriteti Rrugor Shqiptar, bashkitë, komunat apo kompani private);

e) Kontraktori

Është një person juridik, i cili është i ngarkuar me kontratë për të ndërtuar një rrugë apo një strukturë inxhinierike në një nivel të përcaktuar edhe në lidhje me sigurinë rrugore;

f) Rrjeti qendror

Do të thotë rrjeti rrugor shtetëror, duke përfshirë rrugët e rrjetit transeuropian, sipas përcaktimeve në aneksin I, neni 2 të vendimit nr. 1692/96/EC.

Sipas karakteristikave të tyre konstruktive, teknike dhe funksionale, këto rrugë janë të tipit A, B, C dhe D.

g) Projektues

Është person juridik, i cili është i ngarkuar me kontratë për të projektuar një rrugë;

h) Inspektim (Inspektim i Sigurisë Rrugore – ISR)

Është një verifikim për të gjetur defektet për arsye të sigurisë, që kërkojnë punime të mirëmbajtjes;

i) Inspektor (Inspektor i Sigurisë Rrugore)

Është një person juridik ose fizik, i cili është i certifikuar në përputhje me këtë udhëzim dhe kryen funksione sipas këtij udhëzimi;

j) Njësia e auditimit dhe inspektimit të sigurisë rrugore (NJAISR)

Është njësi në strukturën organike të entit pronar të rrugëve, të caktuar nga ky udhëzim dhe e ngarkuar për ASR/ISR;

k) Organi i kontrollit në MPPT (OKMPPT)

Është njësi në strukturën organike të MPPT-së e caktuar për monitorimin dhe kontrollin e procesit të auditimit/inspektimit të sigurisë rrugore;

l) Projekt i infrastrukturës

Nënkupton një projekt për ndërtimin e infrastrukturës rrugore të re apo një modifikim të konsiderueshëm të rrjetit ekzistues, i cili ndikon në rrjedhën e trafikut;

m) Segmente me përqendrim të lartë të aksidenteve

Pjesë të rrjetit rrugor të hapura për trafikun, ku për një periudhë më shumë se tre vjet ka pasur një numër të lartë të aksidenteve fatale në përpjesëtim me rrjedhën e trafikut, pra si rrjedhojë një numër të konsiderueshëm të pikave të zeza;

n) Klasifikim i sigurisë së rrjetit

Një metodë klasifikimi e segmenteve rrugore për sa u përket mundësive për përmirësimin e sigurisë rrugore dhe uljes së kostos së aksidenteve.

KAPITULLI II
AUDITIMI I SIGURISË RRUGORE

Neni 3
Përfitimet nga Auditimi i Sigurisë Rrugore – ASR

1. Auditimi është një pjesë integrale e një sistemi të menaxhimit gjithëpërfshirës të cilësisë gjatë zgjidhjes së projektimit, në projektin e detajuar, para hapjes së rrugës dhe gjatë funksionimit të rrugës deri në fund të jetës së saj.

2. Kryerja e auditimit, për të cilin bën fjalë ky udhëzim, është i detyrueshëm.

3. Përfitimet që rrjedhin nga procesi i auditimit janë:

a) parandalimi i dëmeve njerëzore dhe materiale, që rrjedhin nga aksidentet e trafikut në

rrugën e vlerësuar;

b) shmangia e nevojës për të rindërtuar një rrugë për shkak të mospërputhjes me rregullat e sigurisë në trafik;

c) në përgjithësi auditimi do të bëhet nga një ekip i përbërë nga të paktën dy auditues, ku një anëtar i këtij ekipi, do të mbajë një certifikatë të kompetencës, siç referohet në nenin 11 të këtij udhëzimi;

d) përzgjedhja e ekipit të auditimit, që kryhet nga ana e NJAISR-së, do të bëhet në përputhje me kuadrin ligjor në fuqi, të prokurimit të fondeve publike;

e) audituesit do të jenë të pavarur në lidhje me klientin, projektuesin dhe kontraktorin. Ata do të jenë të pavarur në lidhje me NJAISR-në, për aq sa i përket procesit të auditimit;

f) auditimi do të kryhet në përputhje me rregulloret dhe praktikat më të mira në këtë fushë, në nivel kombëtar dhe ndërkombëtar. Gjatë kryerjes së auditimit, audituesit duhet të përpiqen për të përmbushur kriteret e përcaktuara në këtë udhëzim;

g) audituesit duhet të përcaktojnë elementet kritike të sigurisë në projekt, në një raport të auditimit për çdo fazë të projektit të rrugës;

h) audituesit do t'i japin rezultatet e auditimit klientit të tyre, NJAISR-së (neni 4), si dhe organit të kontrollit në MPPT (neni 5), dhe asnjë personi apo institucioni tjetër. Ata duhet të kenë konfidecialitet absolut për palët e treta;

i) me kërkesë të NJAISR-së, audituesit duhet të ndihmojnë entet pronare të rrugëve për të përmirësuar udhëzimet dhe rregulloret në fushën e aspekteve të sigurisë rrugore. Ky proces do të jetë subjekt i një pagese shtesë.

Neni 4

Njësia e Auditimit dhe Inspektimit të Sigurisë Rrugore – NJAISR

1. NJAISR-ja është një njësi e veçantë në strukturën organike të entit pronar të rrugës.

2. NJAISR-ja do të jetë njësia e vetme kompetente në fushën e auditimit për rrugët kombëtare dhe rrugët private të hapura për trafikun publik. Për rrugët lokale, kjo njësi do të jetë e atashuar pranë bashkive dhe komunave.

3. Detyrat e NJAISR-së në veçanti janë:

a) për të verifikuar kërkesat që një person të bëhet audituesi/inspektor (neni10);

b) për të përpunuar procedurat e përcaktimit të audituesve/inspektorëve të sigurisë rrugore së bashku me MPPT-në dhe MB-në, procedura, të cilat do të publikohen në faqen e internetit të MPPT-së dhe MB-së;

c) të caktojë audituesin/inspektorin;

d) të mbajë regjistrin (neni 13), e regjistrimit të audituesve/inspektorëve të sigurisë rrugore në rrugë, që do të publikohet në faqen e internetit të MPPT-së;

e) të rregullojë aspektet kontraktuale me klientët, për të paguar sipas kontratës, audituesit/inspektorët e sigurisë rrugore që kanë kryer auditimin/inspektimin e sigurisë rrugore, për rregullimin e informacionit dhe të dokumenteve që rrjedhin në mes palëve të përfshira në procesin e auditimit/inspektimit;

f) të mbikëqyrë kryerjen e auditimeve/inspektimeve, përfshirë pavarësinë e audituesit/inspektorit, sipas këtij udhëzimi;

g) të organizojë takime me audituesit/inspektorët, në lidhje me rezultatet kërkimore shkencore në këtë fushë;

h) të bëjë propozime për përditësimin e legjislacionit, normat, standardet dhe udhëzimet teknike në përputhje me rregulloret europiane dhe praktikat më të mira ndërkombëtare;

i) të marrë pjesë në aktivitete të veçanta në nivel kombëtar dhe ndërkombëtar.

4. Detyrat e NJAISR-së miratohen nga MPPT-ja dhe nga këshillat e bashkive dhe

komunave.

5. NJAISR-ja përgatit për MPPT-në në çdo 1 mars të vitit pasardhës, një raport vjetor mbi auditimet/inspektimet e kryera, gjatë vitit të sapombyllur.

6. NJAISR-ja mbikëqyret nga OKMPPT-ja.

Neni 5
Organi i kontrollit në MPPT (OKMPPT)

Organi i kontrollit në MPPT (OKMPPT) ka përgjegjësinë e plotë për monitorimin dhe kontrollin e gjithë procesit të auditimit/inspektimit.

Detyrat kryesore të tij do të jenë:

a) marrja nga klienti dhe krijimi i bazës së të dhënave (*data base*) të audituesve/inspektorëve;

b) administrimi i të gjitha kopjeve të kontratave midis klientit dhe audituesve/inspektorëve;

c) administrimi i listës së projekteve për rrugët e reja;

d) administrimi i listës së investimeve në rikonstruksionin e rrugëve ekzistuese;

e) kontrolli mbi zbatimin e kontratave dhe propozimin e masave ndëshkuese për rastet e moszbatimit të tyre.

Neni 6
Udhëzuesit dhe manualet

Me qëllim që të mbështesin organet kompetente në zbatimin e këtij udhëzimi, si dhe audituesit/inspektorët për kryerjen e auditimeve/inspektimeve të sigurisë rrugore, miratohet udhëzuesi i auditimit dhe inspektimit të sigurisë rrugore, si pjesë përbërëse e këtij udhëzimi.

Neni 7
Auditimi pjesë e periudhës së hartimit të projektit

Klienti do të llogarisë kohën e domosdoshme për kryerjen e auditimit si pjesë e periudhës gjatë hartimit dhe zbatimit të projektit. Shpenzimet për kryerjen e auditimit do të paguhen nga enti pronar i rrugëve, si pjesë e buxhetit të projektit.

KAPITULLI III
INSPEKTIMI I SIGURISË RRUGORE

Neni 8
Qëllimet e inspektimeve të sigurisë rrugore – ISR

1. Inspektimet e sigurisë rrugore janë verifikime të zakonshme, si dhe ato të planifikuara për efekt të mirëmbajtjes, që kanë lidhje me sigurinë rrugore.

Inspektimet e sigurisë rrugore duhet të kryhen në rrugët në funksionim, në mënyrë që të identifikojnë aspektet e sigurisë në rrugë për të parandaluar aksidentet.

2. Qëllimi i inspektimeve është:

a) rritja e sigurisë rrugore;

b) parandalimi i dëmeve njerëzore dhe materiale, që rrjedhin nga aksidentet e trafikut;

c) mënjanimi i volumeve të mëdha të punës për rindërtimin e rrugëve për shkak të mospërputhjes me rregullat e sigurisë në trafik.

3. Përfitimet e inspektimit të sigurisë rrugore janë analoge me ato të ASR-së (neni 3).

KAPITULLI IV
AUDITIMI DHE INSPEKTIMI I SIGURISË RRUGORE

Neni 9
Anëtarë të administratës së enteve pronare të rrugëve ose të kompanive private

1. Audituesë/inspektorë mund të jenë:

a) anëtarët e stafit të administratës së entit pronar të rrugës; apo

b) anëtarët e një institucioni (universiteti) të ngarkuar për auditime; ose

c) konsulentë privatë që plotësojnë kërkesat për të qenë audituesë/inspektorë.

2. Audituesit/inspektorët mund të jenë anëtarë të stafit të autoritetit shtetëror, ose e ndonjë autoriteti lokal dhe kanë për të kryer auditimin në njësitë e veçanta të ngarkuara për auditime dhe nuk do të jenë të përfshirë në planifikimin e mëtejshëm, projektimin dhe ekzekutimin e punës në lidhje me rrugën, e cila po auditohet nga ana e tyre. Ata duhet të jenë të pavarur në lidhje me punën që kryejnë për auditimin.

3. Audituesit/inspektorët nuk duhet të jenë anëtarë të stafit të projektimit dhe të kontraktorit të rrugës së cilës ato po i kryejnë auditimin.

Neni 10
Kërkesat për audites/inspektor

1. Çdo person, i cili dëshiron të bëhet një audites/inspektor, duhet të plotësojë njëkohësisht këto kërkesa:

a) një diplomë universitare në fushën e inxhinierisë së ndërtimit, mekanike apo elektrike;

b) përvojë profesionale në fushën e projektimit të rrugëve ose në fushën e sigurisë rrugore, ose në analiza aksidenti, për të paktën pesë vjet;

c) pjesëmarrje në kurse trajnimi për audites dhe pajisja me një certifikatë si audites/inspektor, sipas kushteve të parashikuara në këtë udhëzim (neni 11);

d) aftësi fizike për të ushtruar detyrën;

e) nuk ka kufizim ligjor për ushtrimin e aktivitetit.

Neni 11
Kurse trajnimi, provime, certifikata

1. Një person, i cili dëshiron të bëhet audites/inspektor i sigurisë rrugore dhe që plotëson kushtet e nenit 10, duhet t'i nënshtrohet një trajnimi të veçantë. Personi duhet të kalojë me sukses një provim për të marrë certifikatën e aftësisë si audites/inspektor. Marrja e certifikatës së aftësisë nuk përbën trajnim të plotë. Audituesi/inspektori duhet të marrë pjesë në kurse periodike trajnimi të mëtejshme (minimumi një në dy vjet).

2. Programet e trajnimit do të kenë këtë përmbajtje:

- Teori

a) njohuri përkatëse të sigurisë rrugore në standardet dhe rregullat teknike të projektimit të rrugëve;

b) materiale që kanë të bëjnë me procesin e auditimit të vendeve dhe organizatave të tjera ndërkombëtare, që kanë eksperiencë në fushën e auditimit të sigurisë rrugore;

c) udhëzuesi i auditimit dhe inspektimit të sigurisë rrugore.

- Praktika

a) shembuj ushtrimorë dhe pjesë projektesh që kanë të bëjnë me auditimin/inspektimin;

b) studime mbi auditime të mëparshme të projekteve tipike të rrugëve (segmente autostrade, rrugë interurbane, rrugë urbane, rrugë lokale, kryqëzime etj.).

3. Kalendari i zhvillimit të programit:

FAZAT	EMËRTIMI	KOHA
I	Pjesa teorike Raste studimore (auditim/inspektim i rrugëve sipas klasifikimit)	3 ditë
II	Pjesa teori Eksperienca auditimi të ndryshme nga vende dhe organizma të tjera ndërkombëtare	3 ditë
III	Pjesa praktike Shembull studimor i një projekti kompleks (vlerë e madhe dhe tipologji të ndryshme rrugësh)	2 ditë
IV	Mbyllja e seminarit dhe pajisja me certifikatë	1 ditë

4. Tarifat e pjesëmarrjes në kurset e trajnimit do të përcaktohen me udhëzim të ministrit që mbulon fushën e transportit.

5. Certifikata e dhënë para hyrjes në fuqi të këtij udhëzimi do të njihet me kusht që personi i plotëson kërkesat e këtij udhëzimi.

Neni 12
Trajnuesit, bashkëpunimi

1. Personi i caktuar me cilësinë e audituesit/inspektorit sipas këtij udhëzimi mund të plotësojë kushtet e një trajnuesi për kurset e trajnimit të audituesve/inspektorëve.

2. MPPT-ja do të bashkëpunojë me universitete të akredituara, institucione dhe organizma profesionalë kombëtarë dhe ndërkombëtarë, që janë me përvojë dhe të autorizuar në fushën e trajnimit profesional, për kryerjen e kurseve të trajnimit dhe programeve të përmirësimit në fushën e auditimeve/inspektimeve. Lista e institucioneve, të parashikuara për bashkëpunim në fushën e auditimeve/inspektimeve, do të bëhet publike në faqen e internetit të MPPT-së, për të qenë e konsultuar nga çdo person i interesuar.

3. Forma e bashkëpunimit do të bazohet në marrëveshjet midis ministrisë që mbulon veprimtarinë e transportit dhe institucioneve referuar pikës 2 më lart.

Neni 13
Regjistri i audituesve/inspektorëve të sigurisë rrugore

1. OKMPPT-ja në përputhje me të dhënat e marra nga NJAISR-ja mbi datën, emrin dhe identifikimin e personave të certifikuar si auditues (neni 11), krijon “Regjistrin e audituesve të sigurisë rrugore.

2. Çdo personi vendas dhe i huaj që i është dhënë cilësia e audituesit/inspektorit jashtë vendit dhe që dëshiron për të kryer aktivitetin e auditimit në këtë vend, ka të drejtë të regjistrohet në “Regjistrin e audituesve/inspektorëve të sigurisë rrugore, në kushtet kur ai paraqet dokumentet që vërtetojnë cilësinë e një audituesi/inspektori të sigurisë rrugore.

3. OKMPPT-ja në përputhje me të dhënat e marra nga NJAISR-ja mbi datën, emrin dhe identifikimin e personave të certifikuar si inspektorë (neni 11), krijon “Regjistrin e inspektorëve të sigurisë rrugore”.

4. OKMPPT-ja në përputhje me të dhënat e marra nga NJAISR-ja mbi datën, emrin dhe identifikimin e personave, të cilët punojnë si trajnerë (neni 12), krijon “Regjistrin e trajnerëve të sigurisë rrugore.

Neni 14
Kontrata

1. Ndërmjet NJAISR-së dhe audituesve/inspektorëve të sigurisë rrugore, do të lidhet një kontratë për performancën e pritshme.

2. NJAISR-ja vendos për auditimet dhe inspektimet që do të kryhen.

3. Audituesi/inspektori nuk mund të refuzojë caktimin nga ana e NJAISR-së për të kryer një auditim/inspektim, përveçse për shkaqe objektive ose për situata të papajtueshmërisë.

Neni 15
Ndërprerja

1. Ndërprerja e kontratës së audituesit/inspektorit mund të bëhet:

a) me kërkesën e audituesit/inspektorit, dërgohet një letër në NJAISR, në të cilën ai deklaron dorëheqjen e tij, duke paraqitur arsyet;

b) me vendim të NjAISR-së në rast se shkelet ndonjë nga pikat e kontratës.

Në rast të ndërprerjes së kontratës, data e ndërprerjes dhe të dhënat e audituesit/inspektorit, do të pasqyrohen në regjistrin e audituesve/inspektorëve.

2. Paragrafi 1 është analog dhe i zbatueshëm edhe në rastin e trajnuesit.

KAPITULLI V
PERFORMANCA E AUDITIMIT DHE INSPEKTIMIT NË FUSHËN E SIGURISË RRUGORE

Neni 16
Dokumentacioni teknik i audituesve/inspektorëve

1. Klienti duhet të plotësojë për NJAISR-në dokumentacionin e projektit që do të auditohet, brenda 10 ditësh pune nga data e nënshkrimit të kontratës së përcaktuar në nenin 15, dhe të njoftojë audituesit/inspektorët e caktuar.

2. Klienti, projektuesi dhe kontraktori do t'i dorëzojnë NJAISR-së dokumentacionin teknik të projektit, që përmban raporte dhe vizatime, si dhe çdo informacion, dokumente, skema, harta apo grafikë të nevojshëm për kryerjen e auditimit në kushte normale. NJAISR-ja do të dorëzojë dokumentet brenda 5 ditëve tek audituesit/inspektorët.

3. Audituesit/inspektorët duhet të ruajnë fshehtësinë mbi informacionin e pranuar, si dhe mbi dokumentet e përpunuara gjatë veprimtarisë së kryerjes së auditimit/inspektimit, me përjashtim të rasteve në të cilat parashikohet ndryshe.

4. Për fazën e 4-t, NJAISR-ja duhet të dorëzojë të dhënat e aksidenteve dhe të dhënat në lidhje me volumin e trafikut.

Neni 17
Papajtueshmëria dhe refuzimi

1. Audituesi/inspektori duhet të informojnë NJAISR-në për çdo rrethanë që ndikon në pavarësinë e audituesit/inspektorit, në lidhje me projektuesin, klientin ose kontraktorin të përfshirë në procesin e auditimit, sapo ai konstaton ekzistencën e një rasti të tillë.

2. Në rastet e refuzimit të kërkesave të auditimit nga ana e klientit me dizavantazhe serioze për sigurinë rrugore, audituesi duhet të informojë me shkrim NJAISR-në dhe mund të kërkojë MPPT-në për ndërhyrje.

Neni 18
Raporti i auditimit/inspektimit

Rezultatet e auditimit/inspektimit duhet të paraqiten nga audituesit/inspektorët në një raport të shkruar dhe të firmosur, në fund të çdo faze të projektit, në përputhje me periudhat kohore të përcaktuara në metodologjinë e auditimit/inspektimit. Raporti i auditimit/inspektimit shpreh qartë dhe saktë mangësitë e identifikuara të sigurisë dhe jep rekomandime.

Neni 19
Përfundimet e raportit të auditimit/inspektimit

1. Është detyrim i klientit për të ndërmarrë veprimet e nevojshme nga rezultatet e raportit, në lidhje me projektuesit dhe kontraktorët, me qëllim që të sigurojë ndërhyrjet e nevojshme para përfundimit të fazës përkatëse të projektit.

2. Në rast se klienti kundërshton kërkesat dhe rekomandimet e raportit të auditimit/inspektimit ai ka për të dhënë një justifikim me shkrim menjëherë për secilin argument.

3. Raporti i auditimit/inspektimit të sigurisë në rrugë dhe arsyetimi me shkrim i klientit duhet të dorëzohen në MPPT brenda 10 ditëve. Këto dokumente do të bëjnë pjesë në dokumentacionin e projektit.

KAPITULLI VI
TARIFAT

Neni 20
Tarifat e auditimit/inspektimit

1. Tarifat për kryerjen e auditimit/inspektimit të sigurisë rrugore do të jenë sipas vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 815, datë 23.11.2011.

2. Kushtet dhe mënyra e pagesës së tarifave nga klienti do të përcaktohen me anë të kontratës dhe do të jenë në përputhje me dispozitat.

KAPITULLI VII
PËRGJEGJËSITË E KLIENTIT, PROJEKTUESIT DHE KONTRAKTORIT

Neni 21
Kundërvajtjet e ankimueshme

Të drejtat, detyrimet dhe shkeljet e klientit, projektuesit dhe kontraktorit do të parashikohen në kontratat tip, duke përfshirë dhe detyrimet ndaj shkeljeve.

1. Veprat e mëposhtme do të përbëjnë kundërvajtje të ankimueshme:

a) Jo pajtueshmëri nga klienti me dispozitat e nenit 10, 11;

b) Jo pajtueshmëri me dispozitat e nenit 12, nga projektuesi, klienti dhe kontraktori;

2. Kundërvajtjet sipas pikës 1 do të dënohen sipas dispozitave në fuqi.

3. Konstatimi i kundërvajtjeve të vogla dhënë sipas paragrafit 1 dhe aplikimi i sanksioneve të parashikuara në paragrafin 2, do të bëhet nga personeli i autorizuar nga entet pronare të rrugës.

KAPITULLI VIII
PËRGJEGJËSITË E AUDITUESIT/INSPEKTORIT TË SIGURISË RRUGORE

Neni 22
Shkeljet e kontratës

Përgjegjësia kontraktuale e audituesit/inspektorit të sigurisë rrugore është e varur nga shkeljet e mëposhtme:

a) shkelje e detyrimit të konfindecialitetit;

b) kryerja e auditimit/inspektimit të sigurisë rrugore në kundërshtim me detyrimet;

c) kryerja e auditimit/inspektimit të sigurisë rrugore në kundërshtim me metodologjinë e auditimit/inspektimit të sigurisë rrugore.

KAPITULLI IX
DISPOZITAT PËRFUNDIMTARE DHE KALIMTARE

Neni 23
Rregullat për NJAISR-në

1. MPPT-ja dhe entet pronare të rrugës, do të marrin të gjitha masat e nevojshme, në mënyrë që të sigurohen hapësirat e nevojshme për grupin e kontrollit në MPPT dhe NJAISR, për të kryer aktivitetin, në përputhje me dispozitat e këtij udhëzimi.

2. Personat që marrin pjesë në kurse trajnimi për audites/inspektorë të sigurisë rrugore me një kohëzgjatje të caktuar, në vend apo jashtë vendit dhe i plotësojnë kushtet e parashikuara sipas nenit 10, 11, mund të kërkojnë certifikatën e aftësisë së audituesit/inspektorit të sigurisë rrugore dhe për regjistrimin në regjistrin e audituesve/inspektorëve të sigurisë në rrugë.

3. Kërkesa duhet të paraqitet në NJAISR pranë Autoritetit Rrugor Shqiptar, në formë të shkruar, brenda 30 ditëve nga data e përfundimit të kursit të trajnimit, së bashku me dokumentet që vërtetojnë plotësimin e kushteve.

4. NJAISR-ja pranë Autoritetit Rrugor Shqiptar verifikon plotësimin e kushteve dhe do të vendosë për dhënien e certifikatës së kompetencës së audituesit/inspektorit të sigurisë rrugore, brenda 15 ditëve nga data e regjistrimit të kërkesës.

Neni 24
Hyrja në fuqi

Ky udhëzim hyn në fuqi pas publikimit në Fletoren Zyrtare.

MINISTRI I PUNËVE PUBLIKE
DHE TRANSPORTIT
Sokol Olldashi

MINISTRI I BRENDSHËM

Flamur Noka

UDHËZUES
PËR AUDITIMIN E SIGURISË RRUGORE
2012

PJESA A. INFORMACION MBI AUDITIMIN E SIGURISË RRUGORE

1. BAZAT RRETH AUDITIMIT TË SIGURISË RRUGORE

1.1 Çfarë është auditimi i sigurisë rrugore

Një auditim i sigurisë rrugore është "një ekzaminim formal i një projekti ekzistues apo të ardhshëm rruge ose trafiku, ku një ekip i pavarur dhe i kualifikuar raporton mbi aksidentet e mundshme të projektit dhe gjendjen e sigurisë".

Auditimi i Sigurisë Rrugore është një vlerësim sistematik dhe i pavarur i treguesve të sigurisë në projektin e infrastrukturës rrugore. Pas parimit "***Parandalimi është më i mirë se kurimi***", ASR-ja bën të mundur që projektimi dhe ndërtimi i objekteve të trafikut rrugor të jetë sa më eficent dhe i sigurt.

Kjo metodë është shumë efektive për sa i përket kostos. Një ekip i aftë auditimi mund të identifikojë dhe eliminojë një element pasigurie në një projekt rruge, riparimi i të cilit mund të kushtonte shumë më tepër pasi të jetë ndërtuar rruga. Me fjalë të tjera, një auditim i sigurisë rrugore mund të eliminojë një problem sigurie, ndërsa është ende një vijë lapsi mbi një letër, se sa të pritet për ndërtimin e projektit dhe shfaqjen e aksidenteve, si dhe instalimin e masave mbrojtëse të kushtueshme.

Brenda fushës së sigurisë rrugore ndodhen dy procese madhore – njëri është **proaktiv**, dhe synon të **parandalojë** aksidentet, ndërkohë që tjetri është **reaktiv** dhe synon të **zvogëlojë** numrin e aksidenteve në një objekt. Procesi i auditimit të sigurisë rrugore është **proaktiv,** ai identifikon problemet e sigurisë para ndërtimit të një rruge. Rishikimet e pikave të nxehta të aksidenteve, në anën tjetër, aplikojnë aftësi të ngjashme teknike, por në një mënyrë **reaktive**. Ky proces përdor të dhënat e aksidenteve dhe aftësitë teknike për të ulur pikat e nxehta të taksidenteve.



Aplikimi sistematik i kontrolleve të sigurisë rrugore do të adresojë nevojat e sigurisë te të gjithë përdoruesit e rrugës: shoferët e automjeteve, çiklistët, automjetet bujqësore dhe këmbësorët. Ideja për auditimin e sigurisë rrugore erdhi për shkak të seksioneve të rrezikshme në rrugë dhe interseksioneve edhe përgjatë rrugëve të reja të ndërtuara në shumë vende.

Pas gati dy dekadave të përvojës me auditimin e sigurisë rrugore në të gjithë botën, si në Britaninë e Madhe, Australi, Suedi, Gjermani dhe Danimarkë, kjo procedurë është e njohur si një mjet inxhinierik nga më të rëndësishmet në duart tona. Me direktivën e Parlamentit Europian dhe të Këshillit nr. 2008/96 "Për menaxhimin e sigurisë në infrastrukturën rrugore", botuar në nëntor 2008, Bashkimi Europian nxori një vendim të qartë të auditimit të sigurisë rrugore, i cili do të jetë i detyrueshëm për rrjetin rrugor transeuropian në vitet e ardhshme. Në direktivë është përmendur ASR-në si pjesë e një pakete të masave të sigurisë rrugore, si në vijim:

- Vlerësimin e ndikimit të sigurisë rrugore;
- Auditimin e sigurisë rrugore për fazat e projektimit të rrugëve;
- Siguri të lartë dhe menaxhimin e rrjetit rrugor në veprim (duke përfshirë menaxhimin e rrezikut të lartë në seksionet rrugore);
- Inspektime të sigurisë rrugore për rrugët ekzistuese;
- Në analizën e thellë në aksident.

Masat e paraqitura janë një pjesë e integruar e menaxhimit të sigurisë rrugore, fig.1:



Figura 1. Auditimi i sigurisë rrugore si pjesë e menaxhimit të sigurisë rrugore

Si pjesë e inxhinierisë së sigurisë rrugore, auditimi i sigurisë rrugore (ASR) ka një marrëdhënie të fortë dhe shumë ngjashmëri me inspektimet e sigurisë rrugore.

Ngjashmëritë dhe dallimet e të dyja procedurave shpjegohen në skicën në vijim, figura 2:



* Sipas përcaktimit në direktivën EU nr. 2008/96.

** Inspektimi i sigurisë rrugore (ISR) me përdorimin e udhëzuesit të ISR-së.

*** Pjesë e studimit të fizibilitetit – me asistencën sa të jetë e mundshme të audituesve.

Figura 2. VNSR, ASR dhe ISR – fazat dhe përgjegjësitë

Auditimi i sigurisë rrugore (ASR) siguron një shtesë, qasje proaktive për sigurinë dhe kundërmasat në inxhinierinë rrugore.

Auditimi i sigurisë rrugore është:

- një proces formal - jo një kontroll informal;
- një proces i pavarur-merret vetëm me çështjet e sigurisë rrugore;
- kryhet nga persona me përvojën dhe trajnimin e duhur;
- kryhet nga persona të pavarur nga projekti i rrugës;

Rezultat i një ASR-je është një raport zyrtar, i cili identifikon mangësitë e sigurisë rrugore dhe nëse është e përshtatshme, bën rekomandime që kanë për qëllim heqjen apo reduktimin e mangësive. Koha e nevojshme për të ndërmarrë një ASR është shumë e shkurtër në krahasim me fazat individuale të planifikimit. Megjithatë, ajo duhet të konsiderohet si fillim në procesin e zhvillimit të skemës.

Përveç tipareve të sigurisë dhe korrigjimit të mangësive të sigurisë përpara ndërtimit të një rruge, jo vetëm që ndihmon në parandalimin e disa përplasjeve të trafikut rrugor, por edhe shmang nevojën për rindërtimin e shtrenjtë (për të korrigjuar mungesat e sigurisë). Kështu, ASR-ja është potencialisht me kosto shumë efikase.

Një mori e skemave për përmirësim të rrugës, mund të auditohet: projekte kryesore autostrade, projekte rehabilitimi të rrugëve etj. Pas ASR-së, kërkesat e sigurisë rrugore duhet të peshohen kundrejt faktorëve të tjerë në një shqyrtim gjithëpërfshirës.

Është e dobishme për të dalluar ndërmjet tri grupeve apo proceseve në një kontroll të sigurisë rrugore - audituesi apo ekipi i auditimit, ekipi i projektimit dhe klienti apo vendimmarrësi. Funksioni i çdo grupi është i ndryshëm, dhe rolet e tyre duhet të jenë konsistente dhe të përcaktuara mirë.

Një auditim mund të kryhet edhe mbi një rrugë ekzistuese – në këtë rast ai quhet një inspektim i sigurisë rrugore. Një inspektim i sigurisë rrugore lejon identifikimin e rreziqeve në rrugët ekzistuese para se të çojnë në aksidente. Inspektimet e sigurisë rrugore janë veçanërisht të dobishme në vendet ku nuk disponohen të dhëna të besueshme dhe të sakta mbi aksidentet dhe atje ku ka nevojë për lëvrim të fondeve të kufizuara për riparime në mënyrë eficente. Normalisht, çdo punë që do të rezultojë nga inspektimi i sigurisë rrugore do të kushtojë, pasi (ndryshe nga një auditim i sigurisë rrugore në një fazë projektimi) duhet alternuar mjedisi i rrugës në fjalë. Disa probleme sigurie të identifikuara nga inspektimi i sigurisë rrugore mund të mos jenë të kushtueshme (p.sh. zëvendësimi i një shenje të vjetër me një të re), ndërkohë që disa të tjera mund të kushtojnë shumë (p.sh. ridrejtimi i një rruge pranë një kryqëzimi për të përmirësuar distancat e pamjes për mjetet që hyjnë). Në përgjithësi, inspektimet e sigurisë rrugore janë më pak eficentë se auditimet e sigurisë rrugore për sa i përket kostos, por që të dyja vlejnë shumë.

Për të qenë eficent, një auditim duhet të kryhet nga profesionistë, të cilët kanë përvojën dhe trajnimin e duhur dhe që janë të pavarur nga projektimi. Në rastin e kryerjes së një auditimi për sigurinë rrugore, projektuesi i projektit të rrugës së re është përgjegjës për projektin. Ekipi i auditimit nuk merr përsipër përgjegjësi për projektin. Ekipi prezanton kontributin e sigurisë rrugore dhe asiston projektuesin e projektit për zvogëlimin e riskut të përdorimit të rrugës së re me aq sa është e mundur. Enti pronar dhe/ose projektuesi marrin në konsideratë një vlerësim të tillë. Projektuesi mbetet përgjegjës për të gjithë vendimet e projektit.

Auditimi i sigurisë rrugore merr në konsideratë sigurinë e të gjithë përdoruesve të rrugës, në të gjitha tipat e rrugëve, siç paraqitet në figurën 3.

Figura 3. Tip përdoruesi rruge në rrugë interurbane dytësore dhe lokale

Procesi i auditimit të sigurisë rrugore ka tetë hapa kryesorë. Këta hapa jepen më poshtë në tabelën 1.

Hapat e auditimit të sigurisë rrugore	Përgjegjësia e:
1. Përzgjedhja e ekipit të auditimit të sigurisë rrugore	Entit pronar të rrugës
2. Vënia në dispozicion të ekipit të auditimit e të gjithë informacionit rreth projektit	Menaxherit të projektit, ekipit të projektimit dhe entit pronar të rrugës
3. Mbajtja e një takimi fillestar – për përshkrimin e projektit dhe punës	Entit pronar të rrugës, menaxherit të projektit dhe ekipit të auditimit
4. Vlerësimi i problemeve të sigurisë nga vizatimet e projektit. Inspektimi i objektit – gjatë ditës dhe natës	Ekipit të auditimit
5. Të shkruarit e raportit të auditimit të sigurisë rrugore	Ekipit të auditimit
6. Mbajtja e një takimi përfundimtar – për të diskutuar problemet e sigurisë të identifikuara nga auditimi	Entit pronar të rrugës, menaxherit të projektit dhe ekipit të auditimit
7. Përgjigja me shkrim ndaj të gjitha rekomandimeve të raportit të auditimit	Menaxherit të projektit
8. Veprimet pasuese, përfshirë zbatimin e ndryshimeve të miratuara në projekt	Menaxherit të projektit

Tabela 1. Hapat kryesorë në procesin e auditimit të sigurisë rrugore

1.2 Përse duhet auditimi i sigurisë rrugore

Gjatë projektimit, projektuesi bën të gjitha përpjekjet për arritjen e përputhshmërisë me standardet e projektimit dhe kërkesat e entit pronar. Është e çuditshme se si neglizhohen elemente bazë kur ne shkëmbejmë sigurinë rrugore me konsiderata të tjera. Auditimi i sigurisë rrugore është një fushë e specializuar, e cila kërkon kualifikimin e duhur të ekipit që e kryen atë (auditimin). Auditimi i sigurisë rrugore lejon ekzaminimin e projektit me qartësi dhe drejtimin e pyetjeve që mund të mos jenë bërë më përpara ose që mund të mos kenë marrë përgjigjen e duhur.
Përfitimet nga kryerja e auditimeve të sigurisë rrugore janë:

- minimizimi i shanseve për shfaqjen e aksidenteve në rrjetin rrugor;
- ulja e seriozitetit të aksidenteve dhe rrjedhimisht dhe e kostove të komunitetit;
- dhënia epërsi sigurisë rrugore ndaj konsideratave të tjera;
- shmangia e nevojave për punime riparuese të kushtueshme – është më e lehtë të ndryshosh një projekt se të modifikosh një seksion me rrezik të lartë të një rruge pasi është ndërtuar.

1.2.1 Fazat në të cilat ndërmerret auditimi i sigurisë rrugore

Auditimet e sigurisë rrugore mund të ndërmerren në pesë faza:

- Faza 1: Faza e projektidesë
- Faza 2: Faza e projektit të zbatimit
- Faza 3: Faza e parahapjes
- Faza 4. Auditimi i punimeve në rrugë
- Faza 5: Rishikim i një rruge ekzistuese.

Sa më herët të kryhet një auditim gjatë proceseve të planifikimit dhe projektimit, aq më shpejt eliminohen problemet e mundshme të sigurisë, dhe për rrjedhojë minimizohet edhe koha e humbur për projektimin në fazat e mëvonshme kur ndryshimet janë të nevojshme.

1.2.2 Cilat projekte rrugore duhet të auditohen?

Projektet rrugore që do të auditohen mund të përzgjidhen në përputhje me klasifikimin e rrugëve; madhësinë, koston (lek) dhe tipin e projekteve ose një përzierje e të gjithë këtyre kritereve. Auditimet e sigurisë rrugore janë të aplikueshme për të gjithë tipat e projekteve të rrugëve, të gjithë tipat e rrugëve dhe të gjitha rrugët ekzistuese. Tabela 2 (më poshtë) jep kriteret për përzgjedhjen e projekteve rrugore që duhen audituar.

1.2.3 Kush duhet ta kryejë auditimin e sigurisë rrugore?

Auditimi i sigurisë rrugore duhet të kryhet vetëm nga një ekip personash me përvojën e mjaftueshme në fushën e sigurisë rrugore.

Ekipi i auditimit ka epërsitë e mëposhtme mbi një auditues të vetëm; përvojat e ndryshme të anëtarëve të ekipit, përpunimi i ideve që mund të rezultojnë nga diskutimet dhe madje thjesht të pasurit më shumë njohuri.

Një auditues i vetëm i sigurisë rrugore, për të qenë i suksesshëm, duhet të ketë përvojë në fushën e sigurisë rrugore dhe aftësinë e hetimit të aksidenteve, si dhe teknikave parandaluese.

Kjo përvojë duhet të jetë e lidhur me kuptimin e:

- inxhinierisë dhe menaxhimit të trafikut;
- teknikat e projektimit dhe të ndërtimit të rrugëve; dhe
- sjelljen e përdoruesve të rrugës.

Njësia e auditimit dhe inspektimit të sigurisë rrugore, në përbërje të strukturës organike të enteve pronare të rrugëve, mund të krijojë një tabelë të dhënash ku mban të regjistruar të gjithë audituesit.

Shumë vende kanë një sistem për regjistrimin e anëtarëve të ekipeve të auditimit në bazë të katër kritereve që jepen më poshtë:

- të kenë përfunduar një kurs trajnimi mbi auditimin e sigurisë rrugore;
- të kenë pesë vjet përvojë në sigurinë rrugore;
- të kenë kryer të paktën 5 auditime, 3 prej të cilëve kanë qenë në fazën e detajimit;
- të kenë përvojë të vazhdueshme në auditimet e sigurisë rrugore, të kryejnë të paktën një auditim në vit.

Përgjegjësi i ekipit të auditimit duhet të plotësojë të paktën tri kriteret e para, ndërsa një anëtar ekipi duhet të plotësojë të paktën dy kriteret e para.

Para fillimit të një auditimi, duhet të jetë e qartë se si do të trajtohen gjetjet dhe rekomandimet. Gjithashtu, duhet të merren në konsideratë rekomandimet e sigurisë dhe të zgjidhen

shkëmbimet e pashmangshme me faktorët e tjerë (siç është kostoja, koha e projektit ose kapaciteti i rrugës).

Preferohet që menaxheri i projektit ose një autoritet tjetër i lartë brenda grupit të projektimit, ose entit pronar të rrugës, ta bëjë këtë dhe të vendosë nëse pranohet ose jo secili rekomandim.

Pavarësisht se gabimet apo sjellja e keqe e drejtuesit të mjetit në përqindjen më të madhe të rasteve, janë shkaku i aksidenteve të trafikut rrugor, nga hulumtimet e shumta ka rezultuar se në një pjesë të aksidenteve rruga ka ndikimin e saj, fig. 4.



Figura 4. Kontributi i faktorëve në aksident

ASR-ja është miratuar si një mjet për të përmirësuar faktorët e mjedisit në rrugë. Me njohuritë e ekspertëve të auditimit në kontrollin sistematik të sigurisë rrugore është e mundur për të zvogëluar numrin dhe ashpërsinë e aksidenteve të trafikut, duke përmirësuar performancën e sigurisë rrugore të një projekti të infrastrukturës.

1.3 Kostoja dhe përfitimet e auditimit të sigurisë rrugore

Auditimet e sigurisë rrugore kanë kosto të ulët dhe përfitim të lartë. Procesi i auditimit është një proces i shëndoshë ekonomikisht për t'u adoptuar dhe zbatuar nga entet pronare të rrugëve.

Kostoja e një auditimi të sigurisë rrugore përfshin:

- koston e punës së ndërmarrë nga ekipi i auditimit;
- koston e ndonjë pune riprojektimi që mund të rezultojë nga auditivi; dhe
- koston e ndonjë ndryshimi që mund të rezultojë nga auditimi (duhet pasur parasysh që ndonjëherë, auditimet mund të prodhojnë ndryshime që mund të ulin koston e projektit).

Kostoja e një auditimi do të ketë një vlerë deri 0,3% nga vlera totale e investimit. Sa më e madhe të jetë vlera e investimit, aq më e vogël është kjo përqindje. Kostoja e një auditimi në përgjithësi është me të vërtetë mjaft e vogël. Kostoja e riparimit të ndonjë pasaktësie varet në faktin e hershmërisë së identifikimit në fazën e projektimit dhe kohës së mbetur të projektimit.

Kostot e problemeve mund të bëhen komponenti madhor i kostos totale të rrugës mbi të gjithë jetën ekonomike të një projekti nëse në rrugë projektohet një problem serioz sigurie.

Auditimet e sigurisë rrugore të projekteve lejojnë ndryshimin e një vije lapsi mbi një plan më shumë se ndryshimin e gjatësive të betonit apo asfaltit në rrugë. Është më pak e kushtueshme për komunitetin nëse problemi shmanget para se të ndërtohet.

Natyrisht, me rishikimet e sigurisë rrugore të rrugëve ekzistuese, nevoja për trajtimin riparues vihet në dukje pasi është ndërtuar rruga. Por, siguria funksionale e një rruge ekzistuese mund të ndryshojë me kalimin e kohës, siç edhe ndryshojnë volumet, tipat e përdoruesve ose përdorimi i tokave fqinje.

Një rishikim i sigurisë rrugore në një rrugë ekzistuese, kur kombinohet me mjete të tjera në dispozicion të specialistit të sigurisë rrugore, lejon ndërmarrjen e veprimit për të siguruar një nivel sigurie të qëndrueshëm me hierarkinë dhe përdorimin aktual të saj.

1.3.1 Përfitimet nga auditimet

Përfitimet nga auditimi i sigurisë rrugore përfshijnë:

- rrugë të reja më të sigurta;
- reduktim i kostos së përjetshme të skemave rrugore;
- uljen e nevojës për modifikimin e skemave të reja pas ndërtimit të tyre;
- kuptim dhe dokumentim më të mirë të elementeve të sigurisë rrugore; dhe
- konsiderim më të dukshëm të nevojave të sigurisë për përdoruesit e rrugës me aftësi të kufizuar.

2. ÇFARË DUHET TË AUDITOHET

2.1 Fusha e aplikimit

Rrugët janë kategorizuar në pajtim me standardet për planifikimin e trafikut, klasifikimin dhe funksionimin e rrjetit rrugor.

Rrugët janë planifikuar, projektuar, ndërtuar, mirëmbajtur dhe operuar në përputhje me standardet përkatëse teknike dhe specifikimet.

Një ASR duhet të ndërmerret në çdo projekt për rrugë të reja apo në ndonjë propozim për ndryshime në rrugët ekzistuese ose mjedis të rrugës që ka të ngjarë të ndryshojë ndërveprime midis përdoruesve të rrugëve të ndryshme apo në mes të përdoruesit e rrugës dhe mjedisin e tyre.

Një ASR është një pjesë integrale e procesit të projektimit, por i pavarur nga projekti aktual. Projektuesi i rrugës së re (ose projekt tjetër i aplikueshëm) mbetet përgjegjës për projektin. Projektuesi duhet të bëjë verifikime të rregullta të implikimeve për sigurinë e punës për përparimin e projektit.

ASR-ja nuk e ndryshon nevojën për një perceptim "siguria e para". Procesi i auditimit ofron, në intervale të rregullta, një vlerësim të pavarur.

Klienti mbetet përgjegjës për projektin përfundimtar dhe duhet të marrë në konsideratë vlerësimet. Në këtë udhëzues, klientë të tillë si: entet pronare të rrugëve kombëtare dhe lokale, ndërmarrjet publike për rrugët publike dhe në raste të veçanta, donatorët e mjeteve financiare janë në çdo rast përfundimtarë dhe vendimmarrësit e rregullt në procesin e projektimit.

Ky udhëzues për auditimin e sigurisë rrugore në projektet e rrugëve, është i zbatueshëm për:

- rrugë të reja, rrugë dhe objekte të tjera të trafikut rrugor;
- projekte të rrugëve (që po rishfaqen, restaurohen, rehabilitohen);
- ndërtime brenda dhe jashtë zonave.

Për rrugët që janë ndërtuar, kushtet mund të kenë ndryshuar në mënyrë të konsiderueshme, për shembull standardet e projektimit, funksioni i rrugës, vëllimi dhe shpërndarja e trafikut, pesha e automjeteve, përdorimi i tokës, dhe hyrjet, të gjitha mund të ndryshojnë. Sipas direktivës 2008/96/CE e 19 nëntorit 2008 "Mbi menaxhimin e sigurisë në infrastrukturën rrugore", auditimi i sigurisë rrugore në fazën finale duhet të kryhet për të parë nëse do të ndodhin probleme të sigurisë në muajin e parë pas hapjes së rrugës.

Për më tepër kjo është e rëndësishme, nga koha në kohë, të inspektojë periodikisht rrjetin ekzistues rrugor me fokus të sigurisë rrugore. Kjo detyrë mund të jetë e koordinuar me hetimin e seksioneve rrugore të rrezikut të lartë. Kjo procedurë është quajtur Inspektimi i Sigurisë Rrugore (ISR) dhe si pasojë do të plotësohet nga një udhëzues për inspektime të sigurisë rrugore në rrugët ekzistuese.

Ky udhëzues jep më shumë detaje në lidhje me procesin e ISR-së.

2.2 Llojet e projekteve

Llojet e projekteve që do të auditohen, detyrimisht do të përcaktohen në bazë të rregullave ligjore.

ASR-ja mund të kryhet për të gjitha llojet e projekteve të rrugëve, edhe pse është mjaft e qartë, se projektet lidhur me rrjetin kryesor të cilat i shërbejnë një vëllimi të lartë të trafikut duhet të jenë në fokusin e administratës.

ASR-ja duhet të zbatohet në mënyrën e mëposhtme:

- në çdo rast për trafikun në projektet e infrastrukturës rrugore me një karakter të detyrueshëm sipas dispozitave ligjore;
- duhet të përdoret edhe për pjesë të tjera të rrjetit kryesor;
- rekomandohet edhe për masat në rrjetin sekondar.

ASR-ja mund të përdoret për rrugët interurbane, si dhe për arteriet urbane.

Asnjë projekt nuk është i vogël për ASR-në:

- projektet e mëdha, p.sh.. Autostradat, rrugët interurbane, anashkalime (*bypass*) etj.;
- projektet mesatare, p.sh.: projektet e rindërtimit dhe të rehabilitimit;
- përmirësime të vogla, p.sh.: rimodelime të vogla, objekte të reja të biçiklistëve, rindërtime të vogla.
- mirëmbajtje e veprave të mëdha, p.sh., mund të jetë bërë për pjesë të veçanta si shënues ose parmakë metalikë.

Duke pranuar nevojën për aplikimin e burimeve aty ku kanë efektin maksimal, auditimet e sigurisë rrugore në projektet e rrugëve të reja duhet të përzgjedhin fazat në përputhje me koston e projektit të rrugës siç jepen në tabelën 2.

FAZA E AUDITIMIT	**Kostoja e projektit të rrugës**		
	Projekte të mëdha (1)	**Projekte të mesme (2)**	**Projekte të vogla (3)**
Planifikimi	Të gjitha projektet	Nuk kërkohet	Nuk kërkohet
Projektideja	Të gjitha projektet	Të gjithë projektet **(4)**	Sipas gjykimit të inxhinierit projektues **(5)**
Projekti i zbatimit	Të gjitha projektet		
Parahapja	Të gjitha projektet	Të gjithë projektet	
Punimet në rrugë	Çdo punim rruge që do të qëndrojë/përdoret për më shumë se dy muaj		
Rishikim i rrugës ekzistuese	Rrugët kryesore duhet të auditohen çdo vit, sipas gjykimit të entit pronar, dhe në varësi të burimeve		

Tabela 2. Kriteret e auditimit të projekteve

Shënime.

1. Projekte të mëdha janë ato, vlera totale e të cilave kalon shumën 100 milionë lekë.
2. Projekte të mesme janë ato, vlera totale e të cilave është mbi 25 milionë lekë.
3. Projekte të vogla janë ato, vlera totale e të cilave është poshtë 25 milionë lekë.
4. Këto projekte mund të auditohen nësecilën prej fazave të dhëna.
5. Këto projekte mund të auditohen nësecilën prej tri fazave të dhëna. Projektet e sugjeruara kryesisht për të përfituar nga një auditim do të përfshijnë ato me shumë konflikte ndërmjet automjeteve dhe përdoruesve të tjerë të rrugës (kryqëzimet e ngarkuara), ku ka shpejtësi të mëdha, ose ku priten ndryshime të mëdha të situatës ekzistuese të trafikut.

Auditimi i sigurisë rrugore merr në konsideratë sigurinë e të gjithë përdoruesve të rrugës, në të gjithë tipat e rrugëve.

STOP

KËSHILLA SIGURIE PËR EKIPET E AUDITIMIT - KËMBËSORËT	
	TË MENDOHET GJITHNJË PËR GRUPET E KËMBËSORËVE Tri grupet më të dobëta të këmbësorëve janë të rinjtë, të moshuarit dhe të intoksikuarit. Kur ndërmerret një auditim i sigurisë rrugore, gjithnjë duhet të mendohet për nevojat e sigurisë për të gjitha kategoritë e këmbësorëve – nevojat e sigurisë të të rinjve, të moshuarve dhe të intoksikuarve.
	SIGURIMI I TRAFIKNDARËSVE TË GJERË Trafikndarësit ndihmojnë këmbësorët në kalimin e rrugës duke pasur një vend të sigurt për të pritur për secilin fluks/drejtim trafiku. Në disa projekte rrugësh, trafikndarësit janë ndërtuar me gjerësi maksimale prej 1m (nga bordura në bordurë). Kjo gjerësi është e pamjaftueshme për mbajtjen e sigurt të këmbësorëve. Trafikndarësit duhet të jenë minimalisht 1.8 m të gjerë dhe duhet të jenë të mbushur dhe jo gropë. Qëndrimi në trafikndarës të paniveluar është i vështirë, veçanërisht për të moshuarit, gjë që mund të çojë në rënien e tyre në trafik.
	RISHIKIMET E SIGURISË RRUGORE DUHET TË KENË PARASYSH GJITHMONË KËMBËSORËT Mirëmbajtja e trotuareve nga gropat dhe defektet e tjera është e rëndësishme për sigurinë e këmbësorëve. Nëse trotuaret nuk e kryejnë më shërbimin e tyre, këmbësorët do të fillojnë të ecin në rrugë, një veprim ky me risk të madh.

KËSHILLA SIGURIE PËR EKIPET E AUDITIMIT - KËMBËSORËT

TROTUARET NË RRUGËT RURALE

Mjetet motorike me shpejtësi të lartë dhe këmbësorët nuk duhet të përzihen. Projektet për rrugë të reja duhet të marrin në konsideratë të gjithë përdoruesit e rrugës. Siguria rrugore ndihmohet nga trotuaret ose bankinat e gjera të ngritura.

QËNDRIMET E AUTOBUSËVE

Qëndrimet e autobusëve duhet të shënohen qartë dhe duhet të jenë larg nga kryqëzimet. Duhet të sigurohet një zonë e pastër për pritje për këmbësorët larg nga korsitë e trafikut. Shumë qytetarë janë pasagjerë autobusësh dhe si të tillë meritojnë akses të sigurt për ta dhe nga autobusët.

SHKOLLAT

Duhet të kihet parasysh efekti i rrugës së re mbi shkollat, spitalet, dyqanet dhe ambientet sportive në afërsi të saj. Shkollat janë destinacioni kryesor për këmbësorët e rinj. Në zonat e dendura urbane, kalimet e kontrolluara në vijat e këmbësorëve (si p.sh. në afërsi të shkollës) janë thelbësore.

KËSHILLA SIGURIE PËR EKIPET E AUDITIMIT – MENAXHIMI I RREZIQEVE ANËSORE NË RRUGË

Rreziqet anësore janë një risk i madh për sigurinë rrugore në rrugë. Ekipi i auditimit të sigurisë rrugore duhet të kuptojë strategjinë prej pesë hapash që përdoret për menaxhimin e rreziqeve anësore dhe për uljen e riskut që i kanoset përdoruesve të rrugës:

Hapi 1 – Mbajtja e automjeteve në rrugë.
Hapi 2 – Largimi i objekteve të fiksuara nga anët e rrugës (brenda zonës së sigurt të përcaktuar).
Hapi 3 – Rivendosja e rreziqeve/pengesave larg rrugës (jashtë zonës së sigurt të përcaktuar).
Hapi 4 – Mënjanimi i rreziqeve për të ulur seriozitetin e përplasjeve.
Hapi 5 – Mbrojtja e automjeteve lëvizës nga rreziqet me parapetë sigurie.

Hapi 1 – Mbajtja e automjeteve në rrugë

Për arritjen e kësaj, duhet një kombinim i mirë i projektimit gjeometrik me informacionin për drejtuesit e automjeteve dhe mirëmbajtjen e rrugëve. Bankinat e ngritura, bordurat e fiksuara kufizuese, treguesit e tjerë kufizues dhe shenjat e drejtimit luajnë rol në uljen e aksidenteve me dalje jashtë rruge.

Hapi 2 – Largimi i rreziqeve nga "zona e sigurt"

Të gjitha objektet e fiksuara (me diametër 100 mm ose më shumë) duhet të largohen nga "zona e sigurt" (në anë të rrugës – gjerësia e saj varet nga shpejtësia dhe volumi i trafikut). Në rrugët me shpejtësi të larta, një zonë normale sigurie është 10 m e gjerë.

a)

b)

Një shtyllë e parrethuar, përbën një rrezik serioz në rrugë, veçanërisht në zonat me shpejtësi të larta (a).

Gjithashtu dhe një parapet betoni që shërben si trafikndarës, i pambrojtur përbën një rrezik shumë serioz (b).

Hapi 3 – Rivendosja e rreziqeve/pengesave larg rrugës (jashtë zonës së sigurt të përcaktuar)

Nëse rreziqet anësore nuk mund të largohen përfundimisht, varianti tjetër është rivendosja e tyre në një pozicion që ofron nivel më të lartë mbrojtjeje për automjetet. Largimi i tyre nga kufiri i rrugës u jep drejtuesve të automjeteve më tepër kohë dhe hapësirë për të shmangur përplasjet serioze. Projektimi i një tombinoje për të zgjeruar rrugën çon kokën e tombinos shumë më larg/anash, duke ulur kështu riskun, vetëm me një rritje të vogël të kostos së ndërtimit.

Hapi 4 – Mënjanimi i rreziqeve për të ulur seriozitetin e përplasjeve

Nëse eliminimi apo largimi i rreziqeve nga zona e sigurt nuk është i mundur, atëherë një variant projektimi i një problemi që toleron/fal më shumë për automjetin dhe personat në të.

Shtyllat e ndriçimit dhe mbajtëset e shenjave mund të projektohen të tilla që të bien pas përplasjes duke ulur kështu seriozitetin e dëmtimeve te personat në automjet.

Hapi 5 – Mbrojtja e automjeteve lëvizëse nga rreziqet me parapetë sigurie.
Kur janë konsumuar katër hapat e parë strategjikë, mund të përdoren parapetët e sigurisë. Qëllimi i parapetëve të sigurisë është mbrojtja e qenieve njerëzore që ndodhen në automjetin në lëvizje nga përplasja me rrezikun. Duhet pasur parasysh se edhe një parapet sigurie është një objekt i fiksuar dhe mund të shkaktojë dëme kur goditet. Përpiquni të minimizoni përdorimin e tyre. Garantoni projektimin dhe instalimin korrekt të tyre.

Ekipet e auditimit duhet t'i shohin me imtësi projektimet e parapetëve të sigurisë
Avantazhi i ekipit të auditimit është për të siguruar një gamë të gjerë aftësish. Përfitimet e një ekipi të auditimit janëse problemet mund të shihen me disa palë sy, ka debat konstruktiv, tërësi aftësish të ndryshme etj.

Ekipi i auditimit duhet të ketë udhëheqës që të ketë kryer shkollën përkatëse universitare dhe të ketë përvojë të rëndësishme në inxhinierinë e sigurisë rrugore, të trafikut rrugor dhe/apo hetim aksidenti. Rreth pesë vjet do të jetë një gjatësi minimale e përvojës. Anëtarët e ekipit normalisht do të kenë arsimin përkatës edhe plus rreth pesë vite përvojë. Audituesit duhet të marrin një trajnim intensiv dhe duhet të kalojnë një procedurë provimi. Përmbajtja e trajnimit duhet të përfshijë sigurinë rrugore lidhur me tema, si: hetim aksidenti, menaxhimin e sigurisë rrugore të rrjetit rrugor dhe inxhinierinë e sigurisë rrugore dhe projektimin.

Kur krijohet një ekip, konsideratë duhet t'i jepet ndonjë veçorie të veçantë të projektit që do të kërkojnë kontribut specialisti. Për shembull, jopërdoruesit e motorizuar dhe të tjerë të rrezikuar shpesh kanë nevoja të veçanta, kalimet hekurudhore apo komplekse të sinjaleve të trafikut, në kryqëzimet e kontrolluar.

6.2 Aspekti ligjor

Përvoja në shumë vende tregon se pretendimet në lidhje me përdorimin e ASR-së nuk kanë qenë një problem. ASR-ja siguron një mjet për të kontrolluar se të gjitha nismat e arsyeshme të sigurisë janë marrë në projektim, ndërtim dhe funksionimin e skemave. Audituesit janë thjesht identifikues të çështjeve të sigurisë dhe ngrenë shqetësime që kanë rëndësi për të rritur nivelin e sigurisë së një rruge të ardhshme apo rruge ekzistuese.

Megjithatë, për një ndërmarrje të saktë të ASR-së, parimet kryesore në lidhje me detyrimin ligjor, mund të shprehen më poshtë:

- Në qoftë se procedurat e auditimit të sigurisë rrugore konsiderohen të kenë një vlerë në publik, përgjegjësia ligjore nuk duhet të përdoret për të parandaluar përdorimin e tyre;

- Dokumentacioni është shumë i rëndësishëm, me të vërtetë thelbësor. Përgjigja e klientit për një raport të auditimit duhet të japë arsyet për të mos pranuar rekomandimin e ndonjë audituesi. Përgjigja duhet të jetë e detajuar dhe e justifikuar;

- Raporti i auditimit, raportimi formal dhe përgjigja duhet të vendosen në dosjen e projektit. Ajo mund të përdoret për çdo hetim; dhe

- një vazhdim i procedurës së veprimeve ose mosveprimeve të marra nga autoriteti rrugor dhe identifikimin se çfarë është thënë dhe bërë në kohë është e dobishme të përgjigjet për audituesit.

Në qoftë se inspektori është një punonjës i administratës publike, përgjegjësia është e rregulluar sipas rregullimit ligjor të detyrimit për punonjësit e sektorit publik.

Nëse ISR-ja do të bëhet nga një kompani konsulente, do të ishte e nevojshme për përdorimin e procedurave të përbashkëta për sigurimin e punës së konsulentëve.

PJESA D. LISTAT E KONTROLLIT TË PËRDORURA PËR ASR-NË

7. LISTAT E KONTROLLIT

Lista e kontrollit të auditimit të sigurisë rrugore – Fizibiliteti				
Çështje	**Po**	**Jo**	**NA**	**Komente**

7.1 Qëllimi i listave të kontrollit

Listat e kontrollit të auditimit të sigurisë rrugore që jepen në këtë pjesë janë përgatitur si orientime. Listat janë hartuar me qëllim uljen e riskut të anashkalimit të ndonjë problemi të rëndësishëm sigurie nga ekipi i auditimit. Ato nuk zëvendësojnë njohurinë, përvojën apo gjykimin.

Listat e kontrollit janë thjesht orientuese dhe mund të jenë ose jo plotësisht të dobishme për të gjitha projektet e rrugëve. Ekipet e auditimit duhet të shtojnë në lista zëra, të cilët konsiderohen si të nevojshëm. Zakonisht listat e plotësuara nuk i bashkëngjiten raportit të auditimit, ato mbahen nga ekipi i auditimit për referenca të mundshme në të ardhmen.

Listat mund të përdoren, gjithashtu, edhe nga projektuesit për t'i ndihmuar në identifikimin e problemeve të mundshme të sigurisë në projektet e tyre para se projekti përkatës t'i nënshtrohet auditimit.

7.2 Kur përdoren listat e kontrollit

Listat e kontrollit përdoren në:

Fazën e planifikimit;

Fazën e projektidesë;

Fazën e projektit të zbatimit;

Fazën e parahapjes;

Skemat e trafikut me punime në rrugë;

Rrugët ekzistuese.

Listat e kontrollit mund të përdoren kur vlerësohen vizatimet e projektit, kur inspektohet objekti dhe kur shkruhet raporti i auditimit.

7.3 Përdorimi i listave të kontrollit

Përcaktohet kompleti i listave të kontrollit që nevojiten. Duhet pasur parasysh këtu që një auditim mund të mbulojë më shumë se një fazë të procesit të projektimit.

Listat e kontrollit duhet të fotokopjohen, kështu që një kopje mund të përdoret në terren. Një auditim i suksesshëm nuk arrihet thjesht nga spostimi i një liste kontrolli. Pikat e dhëna mbulojnë vetëm elementet më të shpeshta në projektim dhe praktikë; ato nuk përfshijnë çdo gjë dhe audituesit duhet të përdorin aftësitë dhe gjykimin e tyre rreth sigurisë me çdo lloj tipari. Nëse njëra nga pikat e dhëna në listat e kontrollit nuk ka lidhje me projektin e audituar, ajo duhet parë në një vështrim më të gjerë për të parë mundësinë e ndonjë pyetjeje akute. Ekipet e auditimit inkurajohen që të mendojnë për sigurinë në tërësi dhe të mos kufizohen vetëm brenda zërave të parashikuar në lista.

Faza e planifikimit

Kontrollet në fazën e planifikimit ndërmerren që në fazat e hershme të planifikimit të një projekti për rrugë të reja në mënyrë që të vlerësohen problemet e sigurisë në aspektet e rrugës, shtrirjes dhe të trajtimit

Çështja	Po	Jo	NA[1]	Komente
1. Përzierja e trafikut A do t'i shërbejë skema e propozuar sigurisë për të gjithë përdoruesit e pritshëm të rrugës?				
2. Kushtet klimaterike A do të jetë rruga e re po aq e sigurt sa edhe praktike edhe nën kushtet klimaterike të zonës (mjegull, shira të forta, erëra)?				
3. Zgjedhja e rrugës A është shtrirja e rrugës po aq e sigurt sa edhe praktike?				
4. Standardet e projektimit të rrugës - A konsiderohen si të sigurt standardet/apo udhëzuesit e rrugës (duke pasur parasysh qëllimin e projektit dhe funksionin e tij në lidhje me përzierjen e trafikut)? - A do të jetë seksioni tërthor, përfshirë bankinat, i sigurt për volumin dhe përzierjen e pritshme të trafikut? - A do të jenë distancat e pamjes në pozicionet e duhura dhe të kapshme në kryqëzime?				
5. Shpejtësia e projektuar - A do të jetë shpejtësia e projektuar e sigurt për sa u përket shtrirjes horizontale dhe vertikale, distancave të pamjes, ngushtimeve ose gjarpërimeve të rrugës? - A do të përputhet limiti i caktuar apo i synuar i shpejtësisë me shpejtësinë e projektuar?				
6. Kryqëzimet - A janë të përshtatshme për sigurinë numri/lloji/vendosja e kryqëzimeve? - A do të jetë secili kryqëzim i sigurt nga pikëpamja e shtrirjes horizontale dhe/ose vertikale?				
7. Aspekte të ndryshme sigurie - Këmbësorë – të rinj, të moshuar, të intoksikuar, të paaftë? - Mjete të tërhequra nga kafshë, përdorues të tjerë të dobët rruge? - Kryqëzim në nivel me hekurudhën? - Bagëti? Qëndrime kamionësh? - Tezga rruge?				

[1] NA[1] = nuk aplikohet

Faza e projektidesë

Në këtë fazë, ekzaminohen çështje të rëndësishme të sigurisë, si: shtrirja e kryqëzimeve dhe shkëmbimeve, seksionet tërthore dhe standardet e përzgjedhura të projektimit.

Çështja	Po	Jo	NA[2]	Komente
Projektimi gjeometrik				
1. Shtrirja vertikale dhe horizontale - A janë shtrirjet horizontale dhe vertikale, sidomos te kryqëzimet, të sigurta dhe në përputhje me kriteret? - A siguron shtrirja njëtrajtshmëri në shpejtësi? - A ka pamje të qartë për drejtuesit e automjeteve dhe këmbësorët në hyrjet e propozuara? - A janë distancat e pamjes dhe të ndalimit të përshtatshme? - A janë të sigurt dhe a e plotësojnë funksionin e rrugës gjerësitë e korsive, bankinat, trafikndarësit dhe veçoritë e tjera të seksionit tërthor? - A janë bankinat të sigurta për t'u përdorur nga mjetet e ngadalta, këmbësorët apo triçiklet?				
2. Distancat e pamjes dhe dukshmërisë A ka projekti kufizime të pamjes për shkak të parapetëve, pajisjeve të rrugës, ambienteve të parkimit, shenjave, peizazhit, këmbëve të urave?				
3. Ndërlidhja e rrugëve ekzistuese/të reja A përbën ndonjë rrezik ndërlidhja e rrugës së re me atë ekzistuese (p.sh. rrezik në kthesë apo anë rruge për shkak të dukshmërisë së dobët)?				
4. Kryqëzimet - A është i saktë dhe i sigurt tipi i kryqëzimit (rrugë tërthore, T, rrethrrotullim, i sinjalizuar etj.)? - A janë të sakta dhe të sigurta pikat e propozuara për kontrollet e trafikut (dhënie përparësie, qëndrimi, sinjalizimi etj.)?				
5. Rreziqe anësore - A mund të lëvizet me automjet në skarpatat anësore (për skarpatat më pak se 1:4)? - A janë vendosur të gjitha pemët dhe shtyllat në distancë të mjaftueshme nga trafiku? - A nevojiten parapetë sigurie? A janë vendosur?				
6. Sinjalet dhe vijëzimet A janë siguruar të gjitha sinjalet dhe vijëzimet e nevojshme të trafikut?				
7. Këmbësorët - A janë marrë në konsideratë nevojat e këmbësorëve (Për kalimin e rrugës, si dhe për ecjen përgjatë saj)? - A është dhënë përparësi e veçantë për grupe të veçanta (p.sh.: të rinj, të moshuar, të paaftë, shurdh apo të verbër)?				
8. Motoçiklistë, triçikle dhe çiklistë A përmban projekti parashikime sigurie për motoçikletat, triçiklet, çiklistët dhe mjetet e tërhequra nga kafshët?				
9. Transporti publik A janë mirëpozicionuar nga pikëpamja e sigurisë qëndrimet e autobusëve?				

[2] NA[2] = nuk aplikohet

10. Mjetet e mirëmbajtjes së rrugëve A është parashikuar në projekt përdorimi i sigurt i mjeteve të mirëmbajtjes së rrugëve?				
11. Ndriçimi - A do të jetë kjo rrugë e ndriçuar? A do të mbahet/ruhet siguria nëse rruga nuk është e ndriçuar? - A do të sigurohen shtylla të thyeshme ose me bazament të lëvizshëm lehtë?				
12. Dranazhimi A parashikohet dranazhim i sigurt, përfshirë një sipërfaqe e mundshme për t'u përmbytur?				

Faza e projektit të zbatimit

Në këtë fazë, duhet të disponohen planet e projektimit gjeometrik, vijëzimit, ndriçimit, peizazhi dhe skema e sinjaleve të trafikut. Auditimi i sigurisë rrugore do t'i ekzaminojë të gjitha këto, duke shënuar tiparet e sigurisë, si: distancën e pamjes, sigurinë e këmbësorëve, dhe rreziqet anësore të projektit të rrugës. Kjo është mundësia e fundit për injektimin e sigurisë nga auditimi para ndërtimit të projektit.

Çështja	Po	Jo	NA[3]	Komente
Çështje projektimi				
1. Shtrirja horizontale dhe vertikale - A përmban projekti ide/pika çorientuese vizive (p.sh. iluzione vizive dhe skicime çorientuese siç mund të jenë vijat e gropave ose të pemëve)? - A përputhen shtrirjet horizontale dhe vertikale me kriteret e dukshmërisë?				
2. Seksionet tërthore tip - A janë të sigurt dhe a i plotësojnë funksionin e rrugës gjerësitë e korsive, bankinat, trafikndarësit dhe veçoritë e tjera të seksionit tërthor? - A janë gjerësitë e bankinave të sigurta për t'u përdorur nga automjetet qëndruese dhe lëvizëse? - A janë gjerësitë e mesit të sakta dhe të sigurta për këmbësorët dhe pajisjet e rrugës? - A janë sipërfaqet e pjerrta të manovrushme? - A përmban projekti parashikime të sakta për parakalimin?				
3. Ndërlidhja e rrugëve ekzistuese/të reja A është i sigurt kalimi nga rruga e vjetër tek e reja?				
4. Pamja në kryqëzime - A do të njihen/kapen në kohën e duhur nga shoferët shtrirja e përgjithshme, funksioni dhe tiparet e tjera? - A do të dallohet/kapet kryqëzimi në kohën e duhur dhe në mënyrë të sigurt?				

[3] NA[3] = nuk aplikohet

Çështja	Po	Jo	NA[3]	Komente
5. Sinjalet e trafikut - A është e sigurt faza/sekuenca e sinjalistikës? - A janë parashikuar ambientet për këmbësorët në vendet e kërkuara? - A është parashikuar koha e duhur për lëvizjet e trafikut dhe të këmbësorëve? - A do të jenë të dukshme llambat e sinjalizimit (p.sh. të mos jenë të penguara nga pemë, shtylla, shenja apo automjete të mëdha)? - A pranon pozicionimi vertikal distanca të sigurta ndalimi në kryqëzim ose në rreshtin e mjeteve prapa?				
6. Rrethrrotullimet - A është parashikuar devijim i mjaftueshëm për të ulur shpejtësinë në hyrje? - A janë ishujt ndarës të përshtatshëm dhe të sigurt për distancën e pamjes, gjatësinë dhe qëndrimin e kalimtarëve?				
7. Kryqëzime të tjera A është kontrolli i trafikut në kryqëzime i sigurt, i qartë dhe i kuptueshëm?				
8. Tokat fqinje - A janë të sigurta hyrjet për/dhe nga tokat/pronat fqinje? - A janë konsideruar nevojat për lëvizje të sigurt të bujqësisë dhe blegtorisë?				
9 Këmbësorët - A mund të kalojnë këmbësorët rrugën të sigurt në kryqëzime, streha dhe kalime këmbësorësh me sinjale? - A mund të ecin të sigurt përgjatë rrugës këmbësorët për shkak të shpatullave të gjera dhe të fiksuara, shtigjeve të kalimit etj.? - A është çdo pikë kalimi e sigurt për t'u përdorur nga të paaftët, të moshuarit dhe fëmijët?				
10. Çiklistët A janë konsideruar nevojat e sigurisë për çiklistët?				
11. Motoçiklistët A janë konsideruar nevojat e sigurisë për motoçiklistët?				
12. Kalorësit dhe bagëtitë A janë konsideruar nevojat e sigurisë për kalorësit, përfshirë përdorimin e kufijve të bankinave dhe rregullat për përdorimin e trasesë së rrugës?				
13. Ngarkesat/mallrat A janë konsideruar nevojat e sigurisë për ngarkesat e transportit me kujdesin dhe sinjalizimin e duhur?				
14. Transporti publik A janë mirëpozicionuar qëndrimet e autobusëve për sa i përket sigurisë?				
15. Ndriçimi - A kërkohet ndriçim dhe nëse po, a është siguruar në mënyrën e duhur? - A duhet të përdoren shtylla të thyeshme apo me bazë të lëvizshme?				
16. Sinjalizimi - A janë vendosur sinjalet në vendet ku mund të shihen dhe lexohen në kohën e duhur? - A do të jenë të kuptueshme sinjalet?				

Çështja	Po	Jo	NA[3]	Komente
- A janë mbajtëset e sinjaleve jashtë zonës së pastër ose të thyeshme?				
17. Skicimi - A do të jenë vijëzimet të qëndrueshëm, të dukshme dhe të qarta? - A janë vënë vijëzimet "ndalim parakalimi" në vendet e duhura? - A janë skicuar mirë vendet e kërkuara (sinjalet për paralajmërim kthese, sinjalet për kështillim shpejtësie, tregues kufiri rruge apo sinjalet e devijimit)?				
18. Rreziqet anësore - A janë vendosur pemët dhe shtyllat në distancën e duhur nga trafiku i lëvizshëm? - A janë përfshirë në vendet e kërkuara shtylla që përkulen lehtë? - A mund të përshkohen kanalet e kullimit në mënyrë të sigurt nga automjetet lëvizës?				
19. Parapetet - A parashikohen parapete vetëm në vendet e duhura (p.sh.: te mbushjet, veprat e artit, pemët, shtyllat)? - A janë fundoret e parapeteve të sigurta?				
20. Parkimi A janë mundësitë e parkimit të përshtatshme për të mos rrezikuar parkimet në anë të rrugës?				
21. Dranazhimet A parashikon projekti dranazhimin në mënyrën e duhur?				
22. Aksesi për urgjenca dhe shërbim të automjetit - A janë bërë parashikime për akses dhe lëvizje të sigurta për automjetet në urgjencë? - A janë vendosur në pozicionet e duhura trafikndarës në karrexhata të ndara (d.m.th. frekuenca, dukshmëria)?				
23. Zgjerime dhe/ose ridrejtime të ardhshme - Nëse kemi të bëjmë me një skemë zgjerimi ose dyfishimi traseje, a është bërë projektimi i duhur për të përcjellë këtë mesazh te shoferët? A është besueshmëria e sinjaleve e kënaqshme)? - A trajtohet në mënyrë të sigurt kalimi nga trase teke në të dyfishtë (dykalimshe)? - Nëse skema do të ndërtohet në faza, a sigurojnë planet e ndërtimit sigurinë maksimale? - A janë kalimet në nivel me hekurudhën, urat dhe rreziqet e tjera të dukshme/spikatura?				

Faza e parahapjes

Para se të hapet rruga e re për trafikun, kjo fazë auditimi synon të garantojë që ndërtimi ka marrë parasysh të gjitha shqetësimet e paraqitura nga auditimet e mëparshëm për të pasur një rrugë "me sa më pak rrezik të jetë e mundur". Kjo është mundësia e fundit për të kontrolluar rreziqet e mundshme që janë të padukshëm gjatë fazës së projektimit, para se publiku të fillojë përdorimin e rrugës.

Çështja	Po	Jo	NA[4]	Komente
1. Dukshmëria A ka pengesa në vijat e pamjes?				
2. Lidhja e rrugëve ekzistuese/të reja A është lidhja e rrugës së vjetër me të renë po aq e sigurt sa edhe praktike?				
3. Dukshmëria e kryqëzimeve A janë kryqëzimet të qarta dhe të dukshme?				
4. Sinjalet e trafikut - A funksionojnë të gjitha sinjalet e trafikut siç duhet dhe në mënyrë të sigurt? - A funksionojnë të gjitha sinjalet për këmbësorët në mënyrën e duhur dhe të sigurt?				
5. Rrethrrotullimet A janë të gjitha rrethrrotullimet dhe ishujt plotësisht të dukshme dhe të kapshme nga të gjitha hyrjet?				
6. Këmbësorët A është rruga e re e sigurt për të gjithë këmbësorët?				
7. Çiklistët A është rruga e re e sigurt për çiklistët?				
8. Motoçiklistët A është rruga e re e sigurt për motoçiklistët?				
9. Ndriçimi - A funksionon i gjithë ndriçimi dhe a është efektiv nga pikëpamja e sigurisë? - A janë kryer inspektime gjatë natës dhe gjatë ditës, përfshirë inspektimet për të gjitha rrugët lidhëse?				
10. Sinjalet dhe vijëzimet - A janë përdorur sinjalet e duhura dhe a janë vendosur në vendet e duhura? - A janë hequr sinjalet dhe vijëzimet e vjetra? A janë hequr shanset për keqkuptime?				
11. Skicimi A është vendosur skicimi dhe vijëzimi i rrugës në vendet e duhura dhe të dukshme?				
12. Parapetët - A janë vendosur të gjithë parapetët e nevojshëm dhe a janë vendosur në vendet e duhura? - A janë vendosur barrierat në mënyrë të tillë që të mos pengojnë pamshmërinë ose pjesë të rrezikshme të rrugës?				
13. Rreziqet anësore - A janë larguar të gjitha rreziqet anësore nga zona e sigurisë? - Nëse ka rreziqe të mbetura, a janë mbuluar siç duhet me parapete				

[4] NA[4] = nuk aplikohet

Çështja	Po	Jo	NA[4]	Komente
sigurie?				
14. Drenazhimet A është drenazhimi i rrugës i përshtatshëm për sigurinë rrugore?				
15. Peizazhi A është peizazhi i saktë për nga pikëpamja e sigurisë?				
16. Aksesi në prona dhe zhvillime A janë të gjitha akseset të sigurta?				
17. Automjetet në urgjencë A janë bërë parashikime për automjetet në urgjencë?				
18. Rezistenca e rrëshqitjeve A përmban sipërfaqja e rrugës rërë ose zhavorr, dhe me rezistencë të mirë rrëshqitjeje?				
19. Zonat e shpejtësisë A shënohet qartë zona e shpejtësisë dhe a është e sigurt?				

Skema të punimeve në rrugë

Objektivi i këtij auditimi është të garantojë mbajtjen në nivelin më të ulët të mundshëm të rreziqeve për punëtorët gjatë ndërtimit të rrugës.

Çështja	Po	Jo	NA[5]	Komente
1. Kontrolli i trafikut - A ekzistojnë kontrollet e menaxhimit të trafikut? - A ekzistojnë kontrolle të përkohshme të trafikut dhe flamurtarët në vendet e kërkuara? - A janë sinjalet e përkohshme të trafikut të dukshme për drejtuesit e mjeteve?				
2. Kontrolli i shpejtësisë A kërkohen sinjale të kufizimit të shpejtësisë? Nëse po, a janë vendosur në vendet e duhura?				
3. Sinjalet A janë vendosur të gjitha sinjalet e drejtimit dhe të rregullores? A janë të spikatura?				
4. Skicimi dhe vijëzimi i shtresës A është siguruar i gjithë skicimi dhe vijëzimi i shtresës?				
5. Parapetët A është nevoja për parapetë për mbrojtjen e punëtorëve ose të rreziqeve të tjera anësore gjatë kohës së punës? Nëse po, a janë instaluar?				
6. Aksesi për në objektin e punës A tregohen akseset për në objekt me distancë të përshtatshme pamjeje?				
7. Këmbësorët, çiklistët, kafshët - A janë marrë në konsideratë lëvizjet e këmbësorëve, të çiklistëve apo kafshëve? - A është siguruar hapësirë e mjaftueshme për të moshuarit dhe ato me aftësi të kufizuar?				
8. Siguria gjatë natës - A është objekti i sigurt për të gjithë përdoruesit e rrugës gjatë natës? - A ka kalim të dukshëm dhe të sigurt për të gjithë përdoruesit e rrugës?				

[5] NA[5]= nuk aplikohet

Rrugët ekzistuese

Auditimi (inspektimi) i sigurisë rrugore në rrugët ekzistuese synon në identifikimin e veçorive, të cilat mund të çojnë në aksidente në të ardhmen për të garantuar trajtimin riparues para problemit.

Çështja	Po	Jo	NA	Komente
1. Dukshmëria, distancat e pamjes - A është distanca e pamjes e përshtatshme për shpejtësinë e trafikut që përdor këtë rrugë? - A është parashikuar distancë e përshtatshme pamjeje për kryqëzimet dhe kalimet?				
2. Parakalimi A janë parashikuar mundësi të sigurta për parakalim?				
3. Lehtësia për drejtuesit e mjeteve A përmban rruga elemente konfuze?				
4. Gjerësitë - A janë gjerësitë e korsive dhe të urave të përshtatshme për volumin dhe përzierjen e trafikut? - A janë gjerësitë e trafikndarësve dhe ishujve të sakta nga pikëpamja e sigurisë?				
5. Bankinat A janë bankinat të përdorshme nga të gjithë përdoruesit e rrugës dhe automjetet?				
6. Pozicioni i kryqëzimeve A ka një ngritje të përshtatshme afër kthesave?				
7. Ndriçimi - A kërkohet ndriçim, dhe nëse po, a është siguruar në mënyrën e duhur? - A duhet të përdoren shtylla të përkulshme apo shtylla me bazë të lëvizshme?				
8. Sinjalet dhe vijëzimet - A janë vendosur sinjalet në vendet ku mund të shihen dhe lexohen në kohën e duhur? - A janë vijëzimet e shtresave në gjendje të mirë?				
9. Paralajmërimi për kthesë dhe skicimi A janë vendosur në vendet e kërkuara të gjitha sinjalet për paralajmërim kthese dhe ato të shtrirjes së treguesve të drejtimit?				
10. Parapetët - A janë vendosur të gjithë parapetët e nevojshëm dhe a janë vendosur në vendet e duhur? - A janë instaluar të gjithë parapetët në mënyrën e duhur?				
11. Sinjalet e trafikut - A funksionojnë në mënyrën e duhur të gjitha sinjalet e trafikut? - A janë sinjalet e trafikut të dukshme për motoristët që afrohen?				
12. Këmbësorët - A janë bërë parashikimet e duhura për të moshuarit, të paaftët, mjetet me rrota, dhe karrocat e bebeve? - A ka një numër të mjaftueshëm pikash ku këmbësorët mund të kalojnë rrugën? - A ekziston shenjë e përshtatshme për këmbësorët pranë shkollave dhe spitaleve?				

Çështja	Po	Jo	NA	Komente
13. Çiklistët - A është gjerësia e shtresave e përshtatshme për numrin e çiklistëve që përdorin rrugën? - A është rruga e biçikletave e drejtë dhe e vazhdueshme? - A janë kanalet e drenazhimit të përshtatshme për sigurinë e çiklistëve?				
14. Transporti publik - A janë mirëpozicionuar qëndrimet e autobusëve për sa i përket sigurisë dhe a kanë pamjen dhe dukshmërinë e duhur nga korsitë e trafikut? - Në zonat rurale, a jepen sinjalet e qëndrimit të autobusëve në avancë?				
15. Defektet e shtresave A ka defekte në shtresa (p.sh.. Ashpërsi ose çarje të mëdha, gropa, materiale të lira etj.), të cilat mund të çojnë në probleme sigurie (p.sh. humbje e kontrollit të timonit)?				
16. Rezistenca e rrëshqitjeve A ka shtresa rezistencën e duhur, veçanërisht në kthesa, shkallëzime të forta dhe hyrjet në kryqëzime?				
17. Pellgjet A përmban shtresa zona ku pellgjet e ujit mund të çojnë në probleme sigurie?				
18. Parkimi A janë bërë parashikimet e duhura për lejimin ose kufizimin e parkimit nga pikëpamja e sigurisë së trafikut?				
19. Peizazhi A është peizazhi i sigurt nga pikëpamja e distancës së pamjes dhe qartësisë?				
20. Aktivitete anësore A ka aktivitete anësore (si p.sh., tezga shitjeje) që mund të çorientojnë drejtuesit e mjeteve?				
21. Kamionët dhe zonat e pushimit A janë zonat e pushimit dhe të parkimit të kamionëve në pikat e përshtatshme?				

SHTOJCA A
ANEKSI 1
LISTA E PLOTË E AUDITIMIT TË FAZËS 1 DHE 2

Struktura e listës kontrolluese				
Fazat e auditimit		Kategoria e rrugëve		
		Autostrada	Interurbane kryesore	Urbane kryesore
1	Projekti paraprak	Aneksi 1.1.1	Aneksi 1.2.1	Aneksi 1.3.1
2	Projekti detajuar	Aneksi 1.1.2	Aneksi 1.2.2	Aneksi 1.3.2
3 dhe 4	Para hapjes së trafikut dhe pas hapjes së trafikut	Aneksi 2.1	Aneksi 2.2	Aneksi 2.3

Shënime

- Auditimet në fazat 1 dhe 2 kanë të bëjnë me dokumentacionin e projektit. Fazat e auditimit 3 dhe 4 janë të lidhura me ndërtimin e rrugës. Prandaj ka një lidhje të fortë me metodën e inspektimit të sigurisë rrugore për rrugët ekzistuese. Për shkak se listat kontrolluese janë në fakt të njëjta, ato janë mbledhur në një mënyrë të veçantë në aneksin 2.

- Në listat kontrolluese për rrugët interurbane kryesore janë gjithashtu të përfshira pyetjet në lidhje me situatën tipike të kalimit të seksionit të rrugës në fshatra të vogla etj.

ANEKSI 1.1.1
LISTA KONTROLLUESE PËR AUTOSTRADAT – PROJEKTI PARAPRAK

Faza 1. Lista kontrolluese. Projekti paraprak Autostrada nr.__nga km ____deri në km ___, datë ___.__.___				
Karakteristikat	**Nr.**	**Pyetje**	**Po (v) Jo (X)**	**Komente**
Faza mëparshme	0	Ka seksioni një vlerësim për ndikimin e sigurisë rrugore, dhe a janë marrë në konsideratë rezultatet e këtij vlerësimi?		
1. Funksionimi i rrugës (projekti dhe elemente operative)	1	A është marrë në konsideratë impakti i projektit në mjedisin rreth rrjetit rrugor?		
	2	A është projekti: - një autostradë me distancë të gjatë; - një autostradë rajonale; ose - një autostradë urbane?		
	3	A janë marrë në konsideratë gjatë fazës së planifikimit gjetjet e mëparshme/dokumente mbi situatën e aksidenteve?		
	4	A janë marrë në konsideratë karakteristika të veçanta të përbërësve të trafikut?		
	5	Është shpejtësia e projektuar e përshtatshme për kategorinë e autostradës (për seksionin dhe kryqëzimet)?		
	6	A ka raste të situatave të tilla si kthesa + malore + kryqëzime etj.?		
	7	A janë përshtatur zona tranzitore me seksionet e tjera të lidhura me rrugën (në rastin e zgjidhjeve për fundin e një autostrade)?		
	8	Është distanca e shikimit për ndalimin e garantuar gjatë tërë seksionit (për 120 km/h = 250 m, 100 km/h = 170 m, 80 km/h = 110 m, zbritjet e gjata = 0%)?		
	9	Është distanca e shikimit të orientimit e garantuar përgjatë tërë seksionit? për 120 km/h → 500 m ► përpara për 100 km/h →300 m ► përpara për 80 km/h → 200 m ► përpara		
	10	Janë të gjitha pengesat me fiksim ose të ngulura që mund të jenë të rrezikshme, të vendosura jashtë zonës së sigurisë (120 km/h >12 m 100 km/h > 9 m 80 km/h > 6 m larg karexhatës)?		
	11	Në rast se pengesa të tilla nuk janë vendosur		

Faza 1. Lista kontrolluese. Projekti paraprak Autostrada nr. nga km deri në km , datë . .				
Karakteristikat	**Nr.**	**Pyetje**	**Po (v) Jo (X)**	**Komente**
		jashtë zonës së sigurisë a janë ato të mbrojtura apo të shmangshme?		
2. Kryqëzimet	1	A janëselektuar kryqëzimet mesatare më të sigurta?		
	2	Janë dimensionet e kryqëzimeve (gjerësi, lartësi, dhe hapësirat) të përshtatshme sipas kategorisë së autostradës?		
	3	A janë marrë masat e mjaftueshme në shpatet për të parandaluar rënien e materialeve (p.sh. rënie gurësh)?		
	4	A ka kullim të mjaftueshëm për autostradën (kanale, ulluqe etj.)?		
	5	A ka pjerrësi diagonale dhe të tërthortë të mjaftueshme si dhe superelevim?		
	6	A janë parashikuar shpatulla të qëndrueshme (si shpatulla të forta apo me çakull)?		
3. Uniformiteti	1	Është uniformiteti i qëndrueshëm apo me ndryshime?		
Uniformiteti, vazhdim	2	A ka tolerancë të përshtatshme për kushtet e drenazhimit kur planifikohet uniformiteti horizontal dhe vertikal (kushtet në rast të kthesave me seksion të pjerrët)?		
	3	A janë të harmonizuara uniformiteti horizontal dhe vertikal?		
	4	A kanë parashikuar elementet e projektimit në krijimin e gropave me ujë?		
	5	A janë marrë në konsideratë principet e vazhdimësisë dhe eliminimit të ndryshimeve të shpejtësive të mëdha?		
	6	A janë ndërmarrë hapa për të parandaluar vlerat minimale të projektimit për elementet e uniformitetit horizontal dhe vertikal që ndodhin së bashku?		
	7	A pengohet shikimi, për shembull nga barrierat e sigurisë, bimë, gardhe, shenjat e trafikut, peizazhi dhe strukturat e urave?		
	8	Në rastin e pjerrësive të forta a ka të parashikuara korsi për ngjitje, a janë ato siç duhet të projektuara?		
	9	Në rastin e pjerrësive të forta a ka vendpushime të nevojshme, në qoftë se ka, a janë projektuar si duhet.		
4. Kryqëzimet në disnivel (për lidhjen e degëve të ndryshme të kryqëzimit me rrjetin ngjitur, përdor listën e plotë të kontrollit të autostradës)	1	Janë të gjitha kryqëzimet në disnivel të nevojshme dhe a është numri, ndarja dhe forma e kryqëzimeve e përzgjedhur si duhet?		
	2	Janë kryqëzimet në disnivel dhe elementet e kryqëzimeve të projektuara në atë mënyrë që ata mund të njihen qartazi në kohë?		
	3	A është vijueshmëria e elementeve të kryqëzimit në disnivel e kuptueshme lehtë?		
	4	Është tipi dhe projekti i kryqëzimit të zgjedhur i përshtatshëm për kategorinë e autostradës?		
	5	Janë korsitë e akselerimit për ngadalësimin dhe përshpejtimin, të duhura dhe të sigurta në projekt?		
	6	A mundet kryqëzimi të dallohet në avancë nga të gjitha anët?		
	7	Është siguruar shikueshmëri e mirë në kryqëzim (kushtet e shikimit)?		
	8	Janë korsitë dhe karexhatat në kthesa me gjerësi të mjaftueshme?		
	9	Janë lëvizjet e udhëzuara në mënyrë të qartë dhe të lehtë për t'u kuptuar?		

Faza 1. Lista kontrolluese. Projekti paraprak Autostrada nr.__nga km ____deri në km ___, datë ___.__.___				
Karakteristikat	**Nr.**	**Pyetje**	**Po (v) Jo (X)**	**Komente**
5. Sinjalet e trafikut, masat e ITS*	1	A janë të nevojshme masat e ITS për komunikim në lidhje me kushtet e trafikut, të tilla si. Aksidentet, bllokimet, kushtet e motit etj.?		
6. Zona shërbimi dhe pushimi, numri i stacioneve të pagesave	1	A ka zona shërbimi dhe pushimi të tilla si pikat e karburantit, restorante, vendparkime etj. A është numri i tyre i mjaftueshëm në rrjetin rrugor?		
	2	A është shikueshmëria e garantuar dhe a janë kushtet e shikimit të mjaftueshme?		
	3	A ka parkimi kontroll elektronik të mjaftueshëm për të parandaluar parkimin në hyrjet dhe daljet dhe/ose gjatë karexhatës?		
Zona shërbimi dhe pushimi, numri i stacioneve të pagesave, vazhdim	4	A janë dimensionet e zonës së parkimit të mjaftueshme për parkim për automjetet e pasagjerëve, kamionëve dhe autobusëve?		
	5	A është pozicioni i zonës së shërbimit ose pjesës tjetër i përshtatshëm për llojet e ndryshme të automjeteve?		
	6	A janë objektet për këmbësorë, të projektuara sigurt (shtigjet lidhëse me restorantet, vendkalimet)?		
	7	A janë hyrjet dhe daljet për në zonat e shërbimit dhe pushimit të planifikuara në pikat me dukshmëri të mirë në përgjithësi?		
	8	A janë marrë masa për të siguruar akses të sigurt për automjetet e shpëtimit/automjetet e mirëmbajtjes/zjarrfikësët?		
	9	A ka stacione pagesash? Nëse është kështu, a janë projektuar në mënyrë të përshtatshme për sigurinë rrugore?		
	10	Janë zonat e parkimit të mjaftueshme me kusht për të minimizuar parkimin ilegal në rrugëkalimin e këmbësorëve dhe në karrexhatë me rreziqet përkatëse ose janë marrë masat përkatëse parandaluese?		
	11	A janë projektuar zona parkimi të sigurta për autobusët turistikë dhe për njerëzit me aftësi të kufizuara?		
7. Transporti publik	1	Do të përdorë transporti publik autostradën?		
	2	Janë të qarta ndalesat e transportit publik në autostradë		
8. Përdoruesit e rrezikuar të rrugës	1	Ju lutem shikoni “zona pushimi” dhe “transportin publik”		
9. Sinjalet, shenjat ndriçimi	1	Janë shenjat e rrugëve të qarta, të dukshme dhe të përshtatshme?		
	2	Është ndriçimi i domosdoshëm për kategorinë e autostradës?		
	3	Është ndriçimi i situatave të veçanta (zonat e tranzitit, ndryshimet në seksionin tërthor) të kërkuara dhe, nëse po, është projektuar në mënyrë të përshtatshme?		
	4	Është ndriçimi stacionar i nevojshëm në udhëkryqet/vende të shërbimit dhe të pushimit dhe, nëse është i nevojshëm, është një projekt i përshtatshëm?		
10. Karakteristikat anësore dhe instalimet pasive të sigurisë rrugore	1	Pengohet shikimi, për shembull nga gardhe të ndryshme/gardhet e borës?		
	2	Janë telefonat e emergjencës në pozicione të përshtatshme dhe të sigurta në lidhje me trafikun?		

* ITS – Sistemi i teknologjisë së informimit

Faza 1. Lista kontrolluese. Projekti paraprak Autostrada nr. nga km deri në km , datë . .				
Karakteristikat	**Nr.**	**Pyetje**	**Po (v) Jo (X)**	**Komente**
10.1 Pajisje të tjera rrugore	3	Janë ekranet kundër verbimit të nevojshme?		
	4	Janë gardhet të nevojshme? Nëse është kështu, është projekti i përshtatshëm?		
	5	Janë të përshtatshme pajisjet rrugore (shenja paralajmëruese të mjegullës, spërkatës automatikë me agjentë antiakull gardhet e borës etj.) të nevojshme dhe/ose të planifikuara në bazë të kërkesave të veçanta të motit?		
10.2 Të mbjellat	1	Janë pemët dhe të mbjellat ekzistuese në një distancë të mjaftueshme larg nga rruga ose jashtë ndikimit të daljes së makinave nga rruga?		
	2	A është shikueshmëria në intereseksionet e siguruara? Apo është shikimi i penguar nga pemët?		
	3	Rritja e bimësisë do të çojë në probleme të ardhshme për sigurinë (p.sh. si rezultat i pengimit ë shikimit, me një diametër trungu të pritshëm më shumë se 8 cm, shenja rrugore të fshehura dhe efekte hijesh, gjethesh që bien në rrugë)?		
	4	A shkakton tipi i bimësisë irritime për përdoruesit e rrugës (p.sh. uniformiteti)?		
	5	A ka rrezik të një monotonie dhe duhet të shmanget kjo gjë me peizazhin?		
10.3 Strukturat e inxhinierisë civile	1	Është e garantuar pajtueshmëria? A evitohet një "shkelje" në vazhdimësinë e shtrirjes?		
	2	Janë pajisjet e sigurisë pasive në lidhje me strukturat të tilla të planifikuara në vende të nevojshme dhe janë ata të projektuara në mënyrë të përshtatshme?		
	3	A janë mbrojtëset metalike të urave dhe instalimet e tjera pasive të sigurisë të lidhura mjaftueshëm? A janë në dokumentet e projektimit të urës të parashikuara detajet përkatëse?		
	4	A janë marrë në konsideratë kërkesat për këmbësorët dhe çiklistët (p.sh. parashikim të shtigjeve të këmbësorëve dhe të çiklistëve)?		
	5	A janë parapetet dhe mbikalimet në një distancë të sigurt nga rruga?		
	6	A ka tunele në pjesën e rrugës?		
	7	A janë tunelet e sigurt, a ka dalje në rastet e emergjencës, ndriçim të mjaftueshëm etj. (përdorimi i kërkesave të Direktivës 2004/54/EC për tunelet është rekomanduese)?		
10.4 Instalimet e sigurisë pasive	1	A janë pengesat e fiksuara të shmangshme, të ngritura në distanca të mjaftueshme apo të mbrojtura?		
	2	A janë instalimet e sigurisë pasive të ngritur në objektet e nevojshme/vende të tilla si shpatet e pjerrëta e të lartë më shumë se 3 m, kanale të thella, pengesat fikse dhe në trafikndarësen e mesit?		

ANEKSI 1.1.2

LISTA KONTROLLUESE PËR AUTOSTRADAT – PROJEKTI DETAJUAR

Faza 2. Lista kontrolluese – Projekti detajuar **Autostrada nr. nga km deri në km , datë . .**				
Karakteristikat	**Nr.**	**Pyetje**	**Po (v)** **Jo (X)**	**Komente**
1. Funksioni, projekti dhe elemente operative	0	A janë marrë në konsideratë rezultatet e auditimit nga faza e mëparshme?		
	1	A janë marrë në konsideratë rezultatet e mëparshme/dokumente mbi situatën e aksidenteve gjatë fazës së planifikimit?		
	2	A është projekti: - autostradë me distancë të gjatë, - autostradë rajonale, ose - autostradë urbane?		
	3	A është përzgjedhur shpejtësia e projektuar saktë për segmentin dhe kryqëzimin në disnivel sipas kategorisë së autostradës?		
	4	A është e garantuar distanca e shikimit për ndalimin gjatë tërë seksionit (për 120 km/h=250 m, 100 km/h = 170 m, 80 km/h = 110 m, zbritjet e gjata= 0%)?		
	5	Është distanca e shikimit të orientimit e garantuar përgjatë tërë seksionit? për 120 km/h → 500 m ▶përpara për 100 km/h → 300 m ▶përpara për 80 km/h → 200 m ▶përpara		
	6	A ka raste të situatave, të tilla si: kthesa + malore + kryqëzime etj.?		
	7	A ka ndonjë plan shtesë të peizazhit për t'u kontrolluar?		
	8	Janë të gjitha pengesat me fiksim ose të ngulura që mund të jenë të rrezikshme, të vendosura jashtë zonës të sigurisë (120 km/h> 12 m 100 km/h > 9 m 80 km/h> 6 m larg karexhatës)?		
	9	Në rast kur pengesa të caktuara nuk janë të vendosura jashtë zonës së sigurisë, a janë ato të evitueshme apo të mbrojtura?		
	10	Është fundi i zonës së ndërtimit larg nga pikat kritike, si p.sh.: majat, tatëpjeta, kthesa, zonat me distancë pamje të kufizuar ose shpërqendruese?		
	11	A janë përshtatur zona tranzitore me seksionet e tjera të lidhura me rrugën (në rastin e zgjidhjeve për fundin e një autostrade)?		
2. Seksioni kryq	1	A janë selektuar kryqëzimet mesatare më të sigurta.		
	2	Janë dimensionet e kryqëzimeve (gjerësi, lartësi, dhe hapësirat) të përshtatshme sipas kategorisë së autostradës?		
	3	A janë marrë masat e mjaftueshme në shpatet për të parandaluar rënien e materialeve (p.sh. rënie gurësh)?		
	4	A ka pajisje të sigurisë pasive të planifikuara në vende të nevojshme dhe janë ato të projektuar në mënyrë të përshtatshme (shih gjithashtu instalimet e sigurisë pasive)?		
	5	A ka kullim të mjaftueshëm për autostradën (kanale, ulluqe etj.)?		
Seksioni kryq, vazhdim	6	A janë instalimet për kullimin, si ulluqet e projektuar për falje gabimi (kthesa me gurë të lëmuar pa cepa të mprehtë)?		
	7	A ka pjerrësi diagonale dhe të tërthortë të mjaftueshme, si dhe superelevim?		
	8	A janë parashikuar shpatulla të qëndrueshme (si shpatulla		

Faza 2. Lista kontrolluese – Projekti detajuar Autostrada nr. nga km deri në km , datë . .				
Karakteristikat	**Nr.**	**Pyetje**	**Po (v) Jo (X)**	**Komente**
		të forta apo me çakull)?		
3. Uniformiteti	1	Është uniformiteti i qëndrueshëm apo me ndryshime?		
	2	A ka tolerancë të përshtatshme për kushtet e drenazhimit kur planifikohet uniformiteti horizontal dhe vertikal (kushtet në rast të kthesave me seksion të pjerrët)?		
	3	A janë të harmonizuara uniformiteti horizontal dhe vertikal (pikat e ndryshimit)?		
	4	A kanë parashikuar elementet e projektimit krijimin e gropave me ujë?		
	5	A janë marrë në konsideratë principet e vazhdimësisë dhe eliminimit të ndryshimeve të shpejtësive të mëdha?		
	6	A janë ndërmarrë hapa për të parandaluar vlerat minimale të projektimit për elementet e uniformitetit horizontal dhe vertikal që ndodhin së bashku?		
	7	A pengohet shikimi, për shembull nga barrierat e sigurisë, bimë, gardhe, shenjat e trafikut, peizazhi dhe strukturat e urave?		
	8	Në rastin e pjerrësive të forta a ka korsi të parashikuara për ngjitje, a janë ato siç duhet të projektuara?		
	9	Në rastin e pjerrësive të forta a ka vendpushime të nevojshme, në qoftë se ka, a janë projektuar si duhet?		
4. Kryqëzimet në disnivel (për lidhjen e degëve të ndryshme të kryqëzimit me rrjetin ngjitur, përdor listën e plotë të kontrollit të autostradës)	1	Janë të gjitha kryqëzimet në disnivel të nevojshme dhe a është numri, ndarja dhe forma e kryqëzimeve e përzgjedhur si duhet?		
	2	Janë kryqëzimet në disnivel dhe elementet e kryqëzimeve të projektuara në atë mënyrë që ata mund të njihen qartazi në kohë?		
	3	A është vijueshmëria e elementeve të kryqëzimit në disnive e kuptueshme lehtë?		
	4	Është tipi dhe projekti i kryqëzimit të zgjedhur i përshtatshëm për kategorinë e autostradës?		
	5	Janë korsitë e akselerimit për ngadalësimin dhe përshpejtimin, të duhura dhe të sigurta në projekt?		
	6	A mundet kryqëzimi të dallohet në avancë nga të gjitha anët?		
	7	Është siguruar shikueshmëri e mirë në kryqëzim (kushtet e shikimit)?		
	8	Janë korsitë dhe karexhatat në kthesa me gjerësi të mjaftueshme?		
	9	Janë lëvizjet e udhëzuara në mënyrë të qartë dhe të lehtë për t'u kuptuar?		
5. Sinjalet e trafikut dhe masat e ITS	1	A janë instaluar masat e ITS për komunikim dhe asistencë drejtuesit të mjetit?		
Sinjalet e trafikut, vazhdim	2	A janë informacionet të dallueshme në mënyrë të qartë të njohura dhe të kuptueshme?		
	3	A është zgjidhje duke ndjekur praktikat ndërkombëtare (simbolet e përdorur, është informacioni i kuptueshëm edhe për shoferët e huaj), për të bërë më të lehtë të kuptueshme?		
6. Zona shërbimi dhe pushimi, numri i stacioneve të pagesave	1	A ka zona shërbimi dhe pushimi, të tilla si: pikat e karburantit, restorante, vendparkime etj. A është numri i tyre i mjaftueshëm në rrjetin rrugor?		
	2	Është e garantuar shikueshmëria e mirë, janë kushtet e		

Faza 2. Lista kontrolluese – Projekti detajuar Autostrada nr.___nga km ____ deri në km ___, datë ___.__.___				
Karakteristikat	**Nr.**	**Pyetje**	**Po (v) Jo (X)**	**Komente**
		syve të mjaftueshme?		
	3	A ka parkimi kontroll elektronik të mjaftueshëm për të parandaluar parkimin në hyrjet dhe daljet dhe/ose gjatë karexhatës?		
	4	Janë dimensionet e zonës së parkimit të mjaftueshme për parkim për automjetet e pasagjerëve, kamionëve dhe autobusëve?		
	5	A është pozicioni i zonës së shërbimit ose pjesës tjetër i përshtatshëm për llojet e ndryshme të automjeteve?		
	6	A janë objektet për këmbësorë, të projektuara sigurt (shtigjet lidhëse me restorantet, vendkalimet)?		
	7	A janë hyrjet dhe daljet për në zonat e shërbimit dhe pushimit të planifikuara në pikat me dukshmëri të mirë në përgjithësi?		
	8	A janë marrë masa për të siguruar akses të sigurt për automjetet e shpëtimit/automjetet e mirëmbajtjes/zjarrfikëset?		
	9	Janë të mjaftueshme zonat e parkimit me kusht për të minimizuar parkimin ilegal në shtigjet lidhëse dhe në karexhatë me rreziqe përkatëse ose janë marrë masat përkatëse parandaluese?		
	10	A ka hapësira të veçanta parkimi për personat me aftësi të kufizuar? Kanë shtigjet lidhës të kalimit gurë kufiri rrugor?		
	11	A ka hapësira të veçanta parkimi të rezervuara për autobusët turistikë (pasagjerët duhet të kenë zona të sigurta për pushim)?		
	12	A ka të parashikuara stacione pagesash? Nëse është kështu, është projekti i përshtatshëm për sigurinë rrugore? A ka njoftime në një mënyrë të mjaftueshme?		
7. Ndalesat e transportit publik	1	A do të përdorë autostradën transporti publik?		
	2	A janë larg autostradës ndalesat e transportit publik?		
8. Nevojat e përdoruesve të pambrojtur të rrugës	1	Ju lutem shikoni “zonat e pushimit” dhe “transportit publik”		
9. Sinjalet e trafikut, shenjat, ndriçimi 9.1 Sinjalet	1	Janë kufijtë e shpejtësisë të planifikuar (në fillim, në fund, në lartësi, në vendndodhje)?		
	2	Është ndalimi i parakalimit për kamionë, autobusë etj., i nevojshëm dhe, nëse po, a është vendosur në vende të përshtatshme?		
	3	A është shikimi i penguar nga trafiku dhe sinjalet e drejtimit?		
Sinjalet, vazhdim	4	Mundet që gjelbërimi të çojë në probleme të sigurisë në qoftë se rritet bimësia (p.sh. si rezultat i shenjave rrugore të mbuluara)?		
	5	A mundet shenjat të njihen në mënyrë të qartë dhe të lexohen (madhësia e shenjave)?		
	6	Janë shevronet ose shenjat e tjera paralajmëruese në kthesa të nevojshme?		
	7	A është sinjali logjik dhe i qëndrueshëm?		
	8	A është fusha e sinjalit për shërbimin dhe pjesa tjetër e qartë?		
9.2 Shenjat	1	Janë shenjat e rrugëve të qarta dhe të dallueshme?		
	2	A korrespondojnë të gjitha sinjalet dhe shenjat pa ndonjë		

Faza 2. Lista kontrolluese – Projekti detajuar Autostrada nr. nga km deri në km , datë . .				
Karakteristikat	**Nr.**	**Pyetje**	**Po (v) Jo (X)**	**Komente**
		kontradiktë?		
	3	Çfarë lloj materiali do të përdoret? A ka rrethana për të cilat, p.sh., shenjat me profil plastike janë rekomanduar.		
9.3 Ndriçimi	1	A është ndriçimi stacionar nëseksione, kryqëzime dhe zonat e shërbimit e të pushimit i parashikuar, në raport me ndriçimin e ambientit?		
	2	A paraqet ndriçimi i ambientit kërkesa të veçanta?		
10. Karakteristikat e instalimeve anësore të sigurisë pasive rrugore	1	A pengohet shikimi, për shembull nga gardhet e borës, lojërave etj.?		
	2	Janë telefonat e emergjencës në pozicione të përshtatshme dhe të sigurt në lidhje me trafikun?		
	3	Janë ekranet kundër verbimit të nevojshme?		
10.1 Pajisjet e tjera rrugore	4	Janë gardhet e lojërave të nevojshme? Nëse është kështu, është projekti i përshtatshëm?		
	5	Janë të nevojshme pajisjet rrugore të përshtatshme (shenja paralajmëruese mjegulle, spërkatës automatike për agjentët shkrirës, gardhet e borës etj.) dhe/ose të planifikuara në bazë të kërkesave të motit të veçantë?		
	6	Do të ketë një sistem të duhur kilometrazhi dhe me tabela?		
10.2 Të mbjellat	1	Janë të gjitha pemët ekzistuese dhe të mbjellat jashtë zonës së sigurisë? 120 km/h > 12 m ;100 km/h > 9m ; 80 km/h > 6 m (Krahaso me planin e peizazhit)		
	2	Rritja e bimësisë do të çojë në probleme të ardhshme për sigurinë (p.sh. si rezultat i pengimit të shikimit, me një diametër trungu të pritshëm më shumë së 8 cm, shenja rrugore të fshehura dhe efekte hijesh, gjethesh që bien në rrugë)?		
	3	A shkakton tipi i bimësisë dhe pemëve irritime për përdoruesit e rrugës (p.sh. uniformiteti)?		
	4	A është shikimi i penguar nga pemët?		
	5	A sigurohet shikim i mirë në kryqëzime apo pengohet nga peizazhi përpara?		
	6	A ekziston plan-peizazhi me përdoruesin rreth trajektores rrugës dhe që merr parasysh përshtypjen e monotonisë?		
	7	A është e garantuar dukshmëria vertikale poshtë mbikalimeve?		
10.3 Strukturat e inxhinierisë civile	1	Është e garantuar pajtueshmëria? A evitohet një “shkelje” në vazhdimësinë e shtrirjes?		
Strukturat e inxhinierisë civile, vazhdim	2	A janë parapetet dhe mbikalimet, shtyllat, mbajtëset e këmbëve të urave në një distancë të sigurt nga rruga?		
	3	A janë pajisjet pasive të sigurisë të këtyre strukturave të planifikuara në vendet e duhura dhe të projektuara siç duhet?		
	4	A është projektimi i sistemeve parmak të urave rregulluar me ndonjë mbrojtëse metalike përgjatë autostradës (i miratuar si konstruksion i përbashkët etj.)?		
	5	A ka kanale të thella (për shembull të bëra nga pjesë parafabrikate betoni) të sistemit të kullimit në zonën e sigurisë?		
	6	A ka tombino në lartësinë e planifikuar?		
10.4 Pengesa të tjera	1	A ka ndonjë pengesë tjetër brenda zonës së sigurisë?		
10.5 Instalimet e sigurisë pasive	1	A janë të shmangshme pengesat e fiksuara, të ngritura në distanca të mjaftueshme apo të mbrojtura?		
	2	Janë pajisjet e sigurisë pasive të planifikuara në vende të		

Faza 2. Lista kontrolluese – Projekti detajuar Autostrada nr.___nga km ____ deri në km ___, datë ___.__.___				
Karakteristikat	**Nr.**	**Pyetje**	**Po (v) Jo (X)**	**Komente**
		nevojshme dhe projektuar në mënyrë të përshtatshme (në fillim dhe në fund të barrierave, vendqëndrimet e bëra pengesë, distanca në mes vendqëndrimeve, stabiliteti, thellësia e vendqëndrimeve, kombinim me guardrail)?		
	3	A ka "dritare të hapura" apo hapësira në sistem (përjashto gjithashtu hapësirat më të shkurtra se 50 m)?		
	4	Janë parashikuar instalimet e sigurisë pasive miratuar për atë lloj përdorimi (përdorimi i EN 1317 është rekomanduar në mënyrë rigoroze)?		

ANEKSI 1.2.1

LISTA KONTROLLUESE PËR RRUGËT INTERURBANE - PROJEKTI PARAPRAK

Faza 1. Lista kontrolluese – Projekti paraprak Rruga interurbane nr. nga km deri në km , datë . .				
Karakteristikat	**Nr.**	**Pyetje**	**Po (v) Jo (X)**	**Komente**
Faza e mëparshme	0	A ka seksioni një vlerësim për ndikimin e sigurisë rrugore dhe, a janë marrë në konsideratë rezultatet e këtij vlerësimi?		
1. Funksionimi i rrugës (projekti dhe elemente operative)	1	A është marrë në konsideratë impakti i projektit në mjedisin rreth rrjetit rrugor?		
	2	A korrespondojnë funksioni dhe përdorimi i dëshiruar i rrugës?		
	3	Janë marrë në konsideratë rezultatet e mëparshme/dokumente mbi situatën e aksidenteve gjatë fazës së planifikimit?		
	4	A ekzistojnë karakteristika specifike të përbërjes së trafikut të cilat duhet të merren në konsideratë?		
	5	Është shpejtësia e projektuar në përshtatje me kategorinë e rrugës?		
	6	Është përdorimi i kufizuar nga grupe të caktuara të përdoruesve i parashikuar ose i përshtatshëm?		
	7	Është aksesi nga pronat kufitare i evituar ose ka një projekt të përshtatshëm për sigurinë në rrugë?		
	8	Ka shpejtësi të projektuar të përzgjedhur saktë për seksionin dhe kryqëzimet?		
	9	Janë marrë masa të përshtatshme për të siguruar që kufijtë e shpejtësisë respektohen, për shembull qetësues trafiku nëpër seksione rrugore?		
	10	Janë përshtatur zona tranzitore me seksionet pranë rrugës (nëse ka ndryshime në karakteristikat apo zgjidhje e përkohshme/në fund të zonës së ndërtimit)?		
	11	Është distanca e shikimit për ndalimin e garantuar gjatë tërë pjesës (për 100 km/h = 170 m, 80 km/h = 110 m, 60 km/h = 65 m, zbritjet e gjata = 0%)?		
	12	Është distanca e orientimit të shikimit e garantuar përgjatë tërë pjesës (për 100 km/h ► 300 m përpara, për 80 km/h ►200 m përpara, për 60 km/h 120 ► m përpara)?		
	13	Është distanca e shikimit të parakalimit në një përqindje të pranueshme (për të paktën 20%) të seksionit të rrugës e siguruar (për 100 km/h ►300 m përpara, për 80 km/h ►200 m përpara, për 60 km/h ► 120 m përpara)?		
	14	A ndodhen pengesat e fiksuara ose të mbjella, të cilat		

Faza 1. Lista kontrolluese – Projekti paraprak Rruga interurbane nr. nga km deri në km , datë . .				
Karakteristikat	**Nr.**	**Pyetje**	**Po (v) Jo (X)**	**Komente**
		mund të jenë të rrezikshme jashtë zonës së sigurisë? 100 km/h > 9m, 80 km/h > 6m, 60 km/h 3m > (nga mjetet që dalin jashtë rruge)?		
	15	Në rast se pengesat fikse nuk janë të vendosura jashtë zonës së sigurisë janë ato të shmangshme ose të mbrojtura?		
	16	A ka raste të situatave, të tilla si: kthesa + malore + kryqëzime etj.?		
2. Seksioni tërthor (kryqëzimi)	1	A janë selektuar kryqëzimet mesatare më të sigurta nga ato që janë diskutuar?		
	2	Janë dimensionet e seksioneve (gjerësi, lartësi dhe hapësirat) të përshtatshme sipas funksionit të rrugës?		
Seksioni tërthor, vazhdim	3	A janë marrë masat e mjaftueshme në shpatet për të parandaluar rënien e materialeve (p.sh. rënie gurësh)?		
	4	Është ngushtimi i karexhatës i kërkuar (grykë shishe) dhe, nëse po, i projektuar në mënyrë të tillë për të garantuar sigurinë e trafikut?		
	5	Janë zonat e parkimit të kërkuara (të ndërtuara në segmentet rrugore) dhe, nëse po, janë ato mjaft të mëdha për të parandaluar parkimin në rrugë?		
	6	Janë marrë në konsideratë nevojat e transportit publik dhe të përdoruesve të tij (p.sh. vendndalim autobusi)?		
	7	A ka ishuj shpëtimi të planifikuara në zonat e ndërtuara, janë vendet e pritjes të mjaftueshme për të pritur këmbësorë (dhe biçiklistë)?		
	8	Në zonat e ndërtuara. A janë marrë në konsideratë kërkesat e këmbësorëve dhe të çiklistëve (rrugë e përbashkët për këmbësorë dhe çiklistë, objekte të veçanta për çiklistë)?		
	9	A ka një ndarje të mjaftueshme (të planifikuar) në mes të korsive për trafikun e automjeteve dhe rrugës për çiklistët dhe këmbësorët?		
	10	A ka drenazhim të mjaftueshëm për rrugën e re?		
	11	A ka seksioni, mbingritje diagonale të mjaftueshme?		
	12	Në rastin e një rruge me katër korsi. A ka të parashikuar ndonjë shirit në mes ose barrierë për ndarjen e drejtimit?		
	13	A ka shpatulla të parashikuara e të qëndrueshme (si shpatulla të forta apo shpatulla zhavorri)?		
3. Uniformiteti	1	A është uniformiteti i qëndrueshëm apo është i mbushur me surpriza?		
